




British Embassy
Tirana



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN



UDHËZUES PËR PERSPEKTIVËN GJINORE DHE PËRFSHIRJEN SOCIALE NË MEDIA



Instituti për
Kontratën
Shoqërore

**UDHËZUES PËR
PERSPEKTIVËN GJINORE
DHE PËRFSHIRJEN
SOCIALE NË MEDIA**

Udhëzues për Perspektivën Gjinore dhe Përfshirjen Sociale në Media

Përgatitur nga Blerta Çani, Delina Fico dhe Iris Luarasi
për Institutin për Kontratën Shoqërore (SCI)

Në kuadër të projektit “Mbështetja e Mediave të Pavarura në Shqipëri”, financuar nga Ambasada Britanike në Tiranë dhe i mbështetur nga partneri zbatues i projektit të USAID-it “Drejtësi për të gjithë”

Tiranë, shkurt 2019

Pikëpamjet e shprehura në këtë Udhëzues janë vetëm të autoreve dhe nuk përfaqësojnë pikëpamjet e SCI, EWMI, të Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri, të USAID apo të qeverisë së SHBA.

Tryeza e Lëndës

I. HYRJE.....	1
II. PERSPEKTIVA GJINORE NË MEDIA	3
A. Koncepte bazë	3
B. Rekomandime.....	6
Përfaqësim dhe raportim i balancuar nga perspektiva gjinore	6
Portretizim i drejtë i grave dhe burrave	8
Raportimi i rasteve të dhunës me bazë gjinore	11
Intervista me ë mbijetuar të dhunës me bazë gjinore	17
C. Burime të vlefshme	21
Dokumente të rëndësishme	21
Burime ndërkombëtare.....	22
Institucione dhe OSHC lokale.....	22
III. PËRFSHIRJA SOCIALE NË MEDIA	25
1. Aftësia e Kufizuar në Media	25
A. Koncepte bazë	25
B. Raportimi	30
Raportimi mbi çështje të aftësive të kufizuara.....	30
Parime etike kur trajtohen çështjet e aftësisë së kufizuar	32
Ndërveprimi me persona me aftësi të kufizuara	34
Terminologjia e përshtatshme.....	36
C. Burime të vlefshme	37
Dokumente të rëndësishme	37
OSHC lokale.....	38
2. Personat LGBTIQ në Media.....	40
A. Koncepte bazë	40
B. Raportimi	44
C. Burime të vlefshme.....	47
Dokumente të rëndësishme	47
Institucione publike dhe OSHC lokale	48

I. HYRJE

Mediat luajnë një rol jashtëzakonisht të madh në formimin e perceptimeve, qendrimeve dhe sjelljeve të njerëzve lidhur me çdo aspekt të jetës dhe të shoqërisë. Ndaj është shumë e rëndësishme që njerëzit e medias - gazetarët në terren dhe në studio, redaktorët, producentët dhe pronarët në mediat tradicionale (gazeta, revista, radio, televizione, agjenci të lajmeve) dhe në mediat e reja (platforma lajmesh, radio dhe televizione në internet, podkaste, etj.), si dhe administratorët e përmbajtjes së faqeve, kanaleve e llogarive në mediat sociale (Facebook, YouTube, Instagram, Twitter, Reddit, Tumblr, etj.) - të kenë njohuritë e duhura dhe burime në dispozicion për të kontribuar në parandalimin e diskriminimit me bazë gjinore dhe të përjashtimit social të grupeve të veçanta, si dhe në përparimin e barazisë gjinore dhe të përfshirjes sociale të grupeve të disavantazuara në shoqërinë shqiptare .

Ky Udhëzues për Perspektivën Gjinore dhe Përfshirjen Sociale në Media synon të ndihmojë mediat në përpjekjet e tyre për ta përshkruar botën dhe njerëzit mbi bazën e respektit për barazinë gjinore dhe për përfshirjen sociale të grupeve të disavantazuara, duke kontribuar kështu në krijimin e një shoqërie më të barabartë dhe më gjithëpërfshirëse në Shqipëri.

Udhëzuesi pasqyron njohuritë, botimet dhe përvojat më të mira në Shqipëri dhe në botë lidhur me fuqizimin e rolit të medias në arritjen e barazisë gjinore dhe të përfshirjes sociale të grupeve të disavantazuara. Ai përfshin ide dhe sugjerime konkrete, si dhe burime informacioni e ndihme, në të cilat njerëzit e medias në Shqipëri mund të kenë qasje lehtësisht.

Udhëzuesi është i përbërë nga dy pjesë kryesore. Pjesa e parë i kushtohet rolit të medias lidhur me barazinë gjinore, ndërsa pjesa e dytë i kushtohet rolit të medias lidhur me përfshirjen sociale të grupeve të disavantazuara. Pjesa e dytë fokusohet në dy grupe kryesore: njerëzit me aftësi të kufizuara dhe personat LGBTIQ. Në secilën pjesë prezantohen, së pari, disa koncepte bazë lidhur me fushën përkatëse, në mënyrë që njerëzit e medias të kenë një ide të qartë e të saktë për këto koncepte. Më pas, Udhëzuesi ofron rekomandime konkrete lidhur me

raportimin në media në një mënyrë që eviton diskriminimin mbi bazë gjinore, diskriminimin e njerëzve me aftësi të kufizuara dhe të personat LGBTIQ, si dhe promovon barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale të grupeve të disavantazhuara. Dhe, së fundi, Udhëzuesi ofron informacion lidhur me; (i) konventa dhe ligje të rëndësishme ndërkombëtare dhe kombëtare në fushat përkatëse, mbi të cilat duhet të bazohen qendrimet dhe veprimet lidhur me barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale; dhe (ii) adresa kontakti të institucioneve dhe organizatave, të cilave mund t'ju drejtohen njerëzit e medias për të marrë më shumë njohuri mbi çështjet e barazisë gjinore, të personave me aftësi të kufizuara dhe të personave LGBTIQ.

II. PERSPEKTIVA GJINORE NË MEDIA

A. Koncepte bazë¹

Seksi: Janë ndryshimet biologjike mes meshkujve dhe femrave, si, p.sh., në organet riprodhuese të burrave dhe të grave.

Përkatësia gjinore: I referohet roleve, sjelljeve, veprimtarive dhe karakteristikave që një shoqëri e caktuar në një kohë të caktuar i sheh si të përshtatshme për burrat apo për gratë. Përkatësia gjinore i referohet edhe marrëdhënieve mes burrave dhe grave, mes djemve dhe vajzave, si dhe marrëdhënieve mes grave dhe marrëdhënieve mes burrave. Këto role, sjellje, karakteristika dhe marrëdhënie zhvillohen në gjirin e mjedisit shoqëror dhe njerëzit i mësojnë ato përmes procesve të socializimit. Rolet, sjelljet, karakteristikat dhe marrëdhëniet gjinore janë specifike për një kontekst shoqëror dhe një kohë të caktuar dhe mund të ndryshojnë në kohë dhe në hapësirë. Përkatësia gjinore është një nga shtresat e identitetit të njeriut, krahas shtresave të tjera si raca, përkatësia etnike, besimi fetar, përkatësia ideologjike, etj.

Stereotipet gjinore: Janë përgjithësime me shtrirje të gjerë lidhur me karakteristikat e një grupi bazuar mbi përkatësinë gjinore, si, p.sh., ‘gratë nuk mund të shërbejnë në ushtri’ ose ‘burrat nuk janë të zotë për të bërë punë shtëpie’. Një nga stereotipet gjinore më të përhapura është portretizimi i grave dhe vajzave jo si individë që ekzistojnë në të drejtën e tyre të mëvetësishme, por të përcaktuara nga raporti që ato kanë me të tjerët, d.m.th., portretizimi i tyre gjithnjë ose kryesisht si nëna, e dashura, bashkëshortja, gjyshja, vajza apo motra e dikujt tjetër.

Qendrimet/gjykime seksiste: Janë qendrimet apo gjykime që bazohen në stereotipe gjinore, sipas të cilave gratë dhe vajzat paraqiten në pozicione të disavantazuar ose/dhe në dritë negative.

¹Shpjegimi i këtyre koncepteve bazohet në përcaktime të përpiluara nga agjenci të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Shiko, për shembull, <http://www.un.org/womenwatch/osagi/conceptsanddefinitions.htm>

Pabarazia gjinore: Në shumicën e shoqërive egzistojnë ndryshime dhe pabarazi mes burrave dhe grave lidhur me përgjegjësitë që ju caktohen atyre, aktivitetet që ata mund të ndër marrin, qasjen që ata kanë në burimet natyrore, financiare dhe njerëzore dhe në kontrollin e këtyre burimeve, si dhe lidhur me mundësitë që kanë gratë dhe burrat për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve.

Barazia gjinore: I referohet të drejtave, përgjegjësisë dhe mundësisë të barabarta për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë. Barazi gjinore nuk do të thotë se gratë dhe burrat do të bëhen e njëjta gjë, por do të thotë së të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë që kanë gratë apo burrat, nuk lidhen me faktin që ata kanë lindur femra apo meshkuj. Barazia gjinore do të thotë, po ashtu, se interesat, nevojat, dhe përparësitë e grave dhe të burrave do të merren në konsideratë, duke mbajtur parasysh edhe larminë e grupeve të ndryshme të burrave apo grave. Barazia gjinore nuk është çështje vetëm e grave, po duhet t'ju interesojë dhe të angazhojë plotësisht gratë dhe burrat. Barazia mes grave dhe burrave është një çështje e të drejtave të njeriut, si dhe kusht i domosdoshëm për një zhvillim të qendrueshëm të shoqërisë.

Përfshirja e perspektivës gjinore: Është procesi, përmes të cilit bëhet vlerësimi i ndikimit që kanë tek burrat dhe tek gratë, veprimtari, ligje, politika dhe programe në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet. Përfshirja e perspektivës gjinore është një strategji për të përfshirë shqetësimet dhe përvojat e grave dhe të burrave në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe të programeve në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore, në mënyrë që gratë dhe burrat të përfitojnë në mënyrë të barabartë prej tyre dhe të mos përsëritet pabarazia.

Feminizmi: Është teoria për barazinë politike, ekonomike dhe shoqërore mes grave dhe burrave, si dhe lëvizjet shoqërore që çojnë drejt realizimit të kësaj barazie.

Dhuna me bazë gjinore: Nënkupton dhunën që ushtrohet ndaj një gruaje apo një burri, vaje apo djali, për shkak të përkatësisë së saj/tij gjinore. Dhuna me bazë gjinore mund të jetë dhunë seksuale (përdhunim), fizike, psikologjike apo ekonomike dhe mund të ndodhe në jetën private apo publike.

Dhuna në familje: Përfshin çdo akt dhune me bazë gjinore ku dhunuesi apo dhunuesja është një njeri që ka lidhje familjare me viktimën e dhunës. Dhuna në familje është një nga format kryesore të dhunës me bazë gjinore.

Dhuna seksuale: Është kryerja e marrëdhënieve seksuale pa pëlqimin e shprehur qartë dhe paraprak të personit tjetër. Dhuna seksuale është një nga format më të rënda të dhunës me bazë gjinore dhe mund të ndodhë edhe në kuadër të një martese.

Viktima apo e mbijetuara/i mbijetuari: Është personi, mbi të cilin është ushtruar dhunë me bazë gjinore. Në Shqipëri, por edhe në rang botëror, rreth 80% e viktimave të dhunës me bazë gjinore janë gra dhe vajza². Të mbijetuarat janë ato viktima që nuk kanë humbur jetën për shkak të dhunës. Përdorimi i termit “e mbijetuara/i mbijetuari” e vë theksin tek fakti se gratë e vajzat, burrat dhe djemtë, që janë viktima të dhunës me bazë gjinore, nuk janë qenie pasive, por ata kanë të drejtën dhe mundësinë që të ecin përpara dhe ta rindërtojnë jetën, pasi i kanë mbijetuar dhunës e janë çliruar prej saj.

Dhunuesi: Është personi që ushtron çdo lloj forme të dhunës me bazë gjinore.

Ngacmimi seksual: Nënkupton oferta të padëshiruara të natyrës seksuale, kërkesa për favore seksuale, si dhe fjalë apo sjellje të natyrës seksuale që nuk janë të mirëpritura nga personi, të cilit i drejtohen. Këto sjellje mund të përfshijnë fjalë të folura, veprime fizike, fjalë të shkruara apo figura. Ngacmimi seksual krijon një mjedis armiqësor në vendin e punës apo të shkollimit dhe ndikon në jetën, punën apo arsimimin e viktimës. Shumica dërrmuese e viktimave të ngacmimit seksual janë gra dhe vajza.

²Duke qenë se shumica dërrmuese e viktimave/të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore janë gra dhe vajza, për lehtësi gjuhësore, në këtë Udhëzues do të përdorim, në të shumtën e rasteve, termat përkatëse në gjininë femërore.

B. Rekomandime

Përfaqësim dhe raportim i balancuar nga perspektiva gjinore

- Përdorni termat ‘gra, vajza, burra, djem’ (përkundrejt termave ‘femra dhe meshkuj’) kur raportoni e flisni për ngjarje dhe çështje politike, ekonomike, shoqërore apo kulturore, duke përfshirë ngjarje që lidhen me jetën private të njerëzve.
- Sigurohuni që gazetarët dhe redaktorët burra e gra të jenë të angazhuar dhe të pranishëm në mënyrë të balancuar në të gjitha aspektet e përgatitjes dhe transmetimit të lajmit apo të një programi mediatik.
- Mblidhni në mënyrë aktive dhe të rregullt të dhëna mbi numrin e grave dhe të burrave që ju paraqisni audiencave tuaja, si dhe mbi rolet dhe kontekstet, në të cilat i paraqisni ata: si personazhe kryesore të lajmeve, si dëshmitarë të një ngjarjeje, si ekspertë, etj. Kjo do t’ju ndihmojë të adresoni mungesat që mund të vini re në përfshirjen e grave dhe të vajzave si subjekte dhe si eksperte në lajmet e programet që ju përgatisni dhe transmetoni.
- Sigurohuni që gratë dhe burrat të jenë në mënyrë të barabartë personazhe, burim informacioni dhe ekspertize në lajme apo programe mediatike.
- Kushtojini kujdes pasqyrimin të ngjarjeve që lidhen me grupe të ndryshme të grave dhe burrave, duke u siguruar që të përfshini edhe grupe që shpesh janë pothuajse të padukshme në media (si, p.sh., gratë në moshë apo ato me aftësi të kufizuara).
- Kujdesuni që burimet e lajmeve apo të programeve tuaja të përfaqësojnë opinione të larmishme që vijnë nga grupe të ndryshme të grave dhe burrave, duke përfshirë grupet shpesh të neglizhuara (p.sh., personat me aftësi të kufizuara, komunitetet etnike, të moshuarit, të varfërit, etj.). Nëse është e nevojshme, konsultohuni me organizata të shoqërisë civile (OSHC) që punojnë për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore ose që përfaqësojnë një grup të caktuar, për të sjellë pikëpamje të balancuara në lajmin apo programin tuaj.

- Përpiquni të arrini një përfaqësim të balancuar të grave dhe burrave në lajme dhe media në të gjitha sferat, duke ju dhënë hapësirë mediatike grave që veprojnë në sfera të dominuara nga burrat, siç janë janë shpesh politika dhe institucionet publike, ekonomia dhe biznesi, shkenca dhe teknologjia, sportet, etj. Nëse keni nevojë, drejtjuni institucioneve publike dhe OSHC-ve për të kërkuar sugjerime lidhur me gra eksperte në këto fusha (shikoni seksionin *Burime të Rëndësishme* më poshtë).
- Krijoni dhe përditësoni një bazë të dhënash me eksperte gra, të cilave mund t'ju drejtoheni sipas nevojës. Kjo bazë të dhënash: do të rrisë shanset e eksperteve gra për t'u bërë më të dukshme në media, duke mundësuar kështu edhe rritjen e profilit të tyre publik; do të luftojë kufizimin e grave vetëm në 'çështje rozë'; dhe do të kontribuojë në rritjen e vëmendjes për çështjet sociale, ekonomike dhe kulturore të grave.
- Kur jeni në rolin e gazetarit të terrenit, drejtuesit të një emisioni në radio apo televizion, apo edhe të moderatorit në një diskutim në një platformë në mediat sociale, krijoni një klimë konstruktive, në të cilën gratë dhe vajzat nuk ndihen nën presion, si dhe sigurohuni që ju jepni kohën e duhur për të folur grave dhe vajzave që janë pjesëmarrëse në një ngjarje apo në një diskutim, duke i nxitur ato, nëse është e nevojshme, që t'i shprehin mendimet e tyre.
- Sigurohuni që një pjesë e ngjarjeve të raportuara të fokusohet në mënyrë specifike tek gratë apo çështjet që konsiderohen si një shqetësim i veçantë për gratë (si, p.sh., dhuna me bazë gjinore, të drejtat e grave, arritjet e grave në fusha të ndryshme, çështje të shërbimit shëndetësor që lidhen me shëndetin e grave, etj.).
- Sigurohuni që në median tuaj t'ju jepet hapësira dhe rëndësia e duhur ngjarjeve që fokusohen në çështjet e pabarazisë dhe barazisë gjinore (ngjarje për raste specifike të barazisë ose pabarazisë midis grave dhe burrave, politika që lidhen me këto çështje, çështjet legislative apo programet e hartuara për të promovuar barazinë gjinore dhe transformimin e normave të pabarabarta gjinore, etj.).

- Informohuni lidhur me lëvizjen feministe dhe lëvizjet për të drejtat e grave në Shqipëri apo në botë dhe shmangni përsëritjen e informacioneve dhe perceptimeve të gabuar për këto lëvizje si, p.sh., lëvizje që bazohen tek urrejtja për burrat apo që kërkojnë t'i kthejnë burrat dhe gratë në qenie krejtësisht të njëjta.
- Konsiderojini aktivistët për të drejtat e grave dhe organizatat që punojnë për përparimin e barazisë gjinore, si burime informacioni dhe ekspertize kur raportoni për çështje të ndryshme politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore, sepse prej tyre mund të përftoni një perspektivë gjinore për këto çështje, perspektivë e cila do të kontribuojë në raportimin shumëplanësh dhe të balancuar lidhur me çështjen në fjalë.

Portretizim i drejtë i grave dhe burrave

- Raportoni mbi ngjarje që transmetojnë paraqitjen shumëdimensionale të burrave dhe grave, duke treguar kështu përpjekjet tuaja prej gazetari/gazetareje për të sfiduar stereotipet me bazë gjinore.
- Shmangni raportimin e ngjarjeve që përforcojnë stereotipet, duke përfshirë interpretimet seksiste të karakteristikave dhe roleve të grave dhe burrave në shoqëri. P.sh., përpiquni të shmangni paraqitjen e vendeve të punës ose të roleve të caktuara si të përshtatshme vetëm për gratë ose burrat, si, p.sh., fermerët janë burra dhe mësuesit në shkollat fillore janë gra.
- Mos i pasqyroni gratë dhe burrat si zotërues të karakteristikave stereotipike gjinore. P.sh., mos lini të kuptohet sikur vajzat janë të ndrojtura dhe djemtë janë të guximshëm, burrat admirohen vetëm për arritjet e tyre profesionale, ndërsa gratë për karakteristikat e tyre fizike, apo sikur gratë dhe vajzat janë pasive, ndërsa burrat dhe djemtë janë aktivë. Po ashtu, kur raportoni mbi viktimat e një ngjarje kriminale apo të dhunës, mos i portretizoni këta njerëz thjesht si viktimat kur ato janë gra, dhe si të mbijetuar kur ata janë burra.
- Gratë kanë të drejtë të trajtohen në media si individë që ekzistojnë në të drejtën e tyre, ndaj nuk duhet të përshkruhen si prona e bashkëshortëve apo baballarëve

të tyre. Në mënyrë të ngjashme, kur një program mediatik i quan vajzat e vogla “princesha”, kjo shprehje mbart supozimin se shoqëria pret që ato të përgatiten për një jetë të lidhur ngushtësisht me këshilla bukurie dhe kozmetikën. Ushqyerja e fiksimit ndaj bukurisë ka një ndikim të madh tek vajzat e vogla dhe mund t’i orientojë ato për ta parë veten dhe vajzat e tjera vetëm si objekte bukurie fizike.

- Sigurohuni që në reklamën, mesazhet dhe imazhet tregtare që përcillen përmes medias suaj, të ketë një portretizim të drejtë të burrave dhe grave. Përpikuni të minimizoni reklamën për kategori produktesh ose shërbimesh që përforcojnë ose normalizojnë stereotipet gjinore, si, p.sh., paraqitja e grave si personazhe kryesore në reklama që lidhen me mallrat shtëpiake për gatim dhe pastrim, ushqim, pije e produkte për fëmijë, ose paraqitja e burrave si personazhe kryesore në reklama që lidhen me mallrat elektronike e sportive; apo paraqitja kryesisht e grave në reklama e produkte tregtare që kanë të bëjnë me shërbimet, arsimin, shëndetësinë, kujdesin për fëmijët dhe paraqitja kryesisht e burrave në reklama e produkte tregtare që kanë të bëjnë me bankat, investimet, pasuritë e paluajtshme, etj. Gjithashtu, kujdesuni që në reklamën që media juaj transmeton, të ketë një raport të balancuar të reklamave ku gratë, ashtu si dhe burrat, shfaqen të sigurt dhe jo pasive.
- Sigurohuni që në reklamën, mesazhet dhe imazhet tregtare që përcillen përmes medias suaj, të shmangët paraqitja e grave dhe vajzave si objekte seksuale.

Mbani parasysh! Partneret ose bashkëshortet e burrave që kanë qenë kandidatë për poste shumë të rëndësishme si, p.sh., Bill Clinton, Nicolas Sarkozy, Barack Obama, Tony Blair, kanë qenë vazhdimisht në qendër të një lloj vëmendjeje mediale që nuk do t’i kushtohet, fjala vjen, partnerit ose bashkëshortit të një gruaje kandidate si, p.sh., burrit apo partnerit të Hillary Clinton, Sarah Palin, Ségolène Royal apo Angela Merkel. Raportimi në media mbi këto partnere të burrave në pozita drejtuese është i prirur të përqendrohet në meritën e këtyre grave (ose mungesën e kësaj merite) për të qenë ikona bukurie apo bashkëshorte shembullore, si një vlerë e shtuar gjatë fushatës zgjedhore dhe madje edhe gjatë mandatit, në rast se kandidati në fjalë ka fituar zgjedhjet.

- Shmangiuni portretizimit të grave në pozita drejtuese në politikë, sektor privat, apo në sektorë të tjerë si “femërore” dhe përfaqësuese të seksit të dobët ose si udhëheqëse të ashpra me tipare mashkullore, të cilat “e tradhëtojnë anën tyre femërore”.
- Kujdesuni që raportimi mbi gratë kandidate, politikane, gratë drejtuese në sektorin privat apo në role të tjera publike të mos jetë diskriminues në bazë të gjinisë dhe mos përdorni standarte të ndryshme nga ato që përdorni kur raportoni mbi burra në pozita drejtuese. Pyeteni veten:
 - A do ta raportoja këtë ngjarje nëse do të ishte fjala për një burrë?
 - A do të përdorja të njëjtat epitete dhe shprehje, nëse do të isha duke raportuar mbi një burrë?
 - A do t’i rendisja në të njëjtën mënyrë informacionet në lajm, nëse do të bëhej fjala për një burrë?
 - A do të flisja për jetën e saj private, a do të komentoja për pamjen e jashtme dhe veshjen e saj njësoj siç do të bëja po të ishte një burrë?
 - A do të përdorja të njëjtin tip fotografish, nëse do të isha duke raportuar mbi një burrë? P.sh., a po përdor fotografi që fokusohen tek trupi i kësaj gruaje?

Mbani parasysh!

- *Dhuna me bazë gjinore është krim dhe dënohet si i tillë në bazë të legjislacionit shqiptar.*
- *Pjesa dërmuese e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës seksuale nuk raportohen.*
- *Zakonisht dhuna seksuale ushtrohet nga një njeri, të cilin viktimja e njeh.*
- *Çdokush mund të jetë ose të bëhet viktimë/i mbijetuar i dhunës në familje dhe dhunës seksuale.*
- *E mbijetuara e dhunës me bazë gjinore mund të mos e raportojë dhunën menjëherë pasi ka ndodhur.*
- *Fajtor për dhunën me bazë gjinore është vetëm dhunuesi e kurrë viktimja. P.sh., nëse një viktimë e dhunës seksuale është veshur në mënyrë provokuese ose ka konsumuar shumë alkool, përgjegjësia dhe faji për dhunën është krejtësisht i personit që ka ushtruar dhunë. Kjo qasje është e sanksionuar me ligj.*
- *Mos hamendësoni sikur viktimja e dhunës seksuale apo e dhunës në familje mund të kishte bërë diçka për ta parandaluar atë, ose që dhunuesi është në ndonjë mënyrë i justifikuar për dhunën që ka ushtruar.*
- *Të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës seksuale përjetojnë traumave, të cilat mund të kenë ndikime afatshkurtra ose afatgjata në shëndetin mendor dhe fizik të së mbijetuarës, por edhe të viktimave dytësore, si, p.sh., pjesëtarët e familjes së të mbijetuarës.*
- *Edhe nëse përvoja e viktimës/të mbijetuarës bëhet pjesë e procesverbalit në gjykatë, ajo ka të drejtën e privatësisë, respektit, dinjitetit dhe përfaqësimit të vërtetë të asaj që ka ndodhur.*

Raportimi i rasteve të dhunës me bazë gjinore

- Kur raportoni raste apo krime të lidhura me dhunën me bazë gjinore (vrasje si pasojë e dhunës në familje, raste përdhunimi, dhunë fizike, sulme seksuale në masë në vende jashtë Shqipërisë ku ka konflikte të armatosura, etj.) mbani parasysh se ka shumë mundësi që raportimi në media mbi këto raste të shkaktojë trauma dhe dëmtime të reja. Ndaj, përgatituni mirë dhe vlerësoni në çdo hap ndikimin e veprimeve tuaja si gazetarë, redaktorë, apo producentë mbi viktimat e dhunës, familjet e komunitetin ku ata jetojnë dhe punojnë, si dhe mbi audiencat e medias suaj.
- Në çdo përpjekje për të dokumentuar dhunën me bazë gjinore me qëllim që të raportoni mbi të në media, duhet t'ju jepni përparësi absolute sigurisë dhe interesave të së mbijetuarës së kësaj dhune në raport me objektiva të tjerë që mund të keni ju ose audiencat tuaja, si, p.sh., informimi i publikut, raportimi mbi përgjigjen nga policia lidhur me ngjarjen në fjalë, rritja e ndërgjegjësimit të publikut lidhur me dhunën me bazë gjinore apo promovimi i organizatave që ndihmojnë të mbijetuarat e dhunës mbi bazë gjinore.
- Respektoni në çdo rast të drejtën e të mbijetuarës që të ruajë dinjitetin e saj dhe të trajtohet me dinjitet, të ruajë privatësinë dhe konfidencialitetin, si dhe sigurinë dhe mbrojtjen e saj nga dëmet apo ndëshkimet. Vlerësoni në çdo hap nëse raportimi i një ngjarjeje përbën shkelje të këtyre parimeve themelore.
- Mos raportoni kurrë detaje që mund ta vënë në rrezik të mbijetuarën. Mos raportoni emrin, fotografinë e të mbijetuarës, karakteristika specifike fizike ose detaje të tjera identifikuese të saj, të pjesëtarëve të familjes ose të personave që po e ndihmojnë të mbijetuarën.

Mbani parasysh! Një rast i dhunës me bazë gjinore (dhunë seksuale, dhunë në familje, dhunë fizike, psikologjike apo ekonomike) dhe mënyra se si familja, komuniteti dhe shoqëria e trajtojnë atë, e transformojnë përgjithmonë jetën e viktimës së dhunës. Mediat kanë një rol shumë të rëndësishëm: (i) për ta parandaluar dhunën me bazë gjinore; (ii) për t'i mbrojtur viktimat e kësaj dhune; dhe (iii) për të bërë presion mbi institucionet publike që ato të fuqizojnë masat për parandalimin dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore.

- Trajtoni edhe ngjarje pozitive që pasqyrojnë fuqizimin dhe rezistencën e të mbijetuarve të kësaj dhune, sepse kjo nxit gra dhe vajza të tjera që janë viktima të dhunës, që ta raportojnë atë dhe të shpresojnë për një jetë pa dhunë.
- Jini të kujdesshëm që të mos e pasqyroni dhunën me bazë gjinore si “normale” ose si pjesë të kulturës së një vendi. Argumenti kulturor është i pambështetur në fakte dhe, për më tepër, mund të përdoret nga njerëz të caktuar si justifikim për dhunën apo për të mos ndërmarrë veprime për ta parandaluar atë dhe për të mbrojtur viktimat e kësaj dhune.
- Shmangni përdorimin e një gjuhe që përcjell gjykim për të mbijetuarat. P.sh., nëse flisni për historinë e jetës së një të mbijetuarë, orientimin e saj seksual, veshjen e saj, ku ishte dhe çfarë po bënte në momentin që ndodhi dhuna, të gjitha këto mund të mbështesin idenë se e mbijetuara është disi fajtores për dhunën e ushtruar ndaj saj. Në përgjithësi, shmangeni raportimin e faktorëve rrethorë si këta të përmendur më sipër, kur raportoni për raste të dhunës me bazë gjinore.
- Përdorni formën aktive të foljeve (p.sh., “dhunuesi e goditi viktimën me sende të forta”) kur raportoni mbi një rast të dhunës me bazë gjinore, sepse hulumtimet tregojnë se, kur lajmet mbi dhunën me bazë gjinore shkruhen në formën pasive (p.sh., “viktima u godit me sende të forta”),: (i) lexuesit/dëgjuesit/shikuesit burra e djem e ndjejnë më pak dëmin që i është bërë viktimës dhe e fajësojnë më pak dhunuesin; dhe (ii) lexuesit/dëgjuesit/shikuesit burra e djem dhe gra apo vajza, janë më tolerantë ndaj abuzimit.

Duhet të shmangni	Duhet të përdorni
Përdorimin e termit “pretendim” për raste të dhunës seksuale, dhunës në familje, apo dhunës fizike. Kjo përforcon mosbesimin mbi kryerjen e krimin.	Termin “denoncim” si term neutral ose “kallëzim” kur një rast dhune me bazë gjinore është marrë në dorë nga sistemi i drejtësisë.
Etiketimin e viktimës si “akuzues/e”, pasi ky term përforcon stereotipet negative.	Termin “viktimë” (i cili është edhe termi në përdorim nga sistemi i drejtësisë penale për raste të dhunës me baza gjinore) ose “e/i mbijetuar”.
Shprehjen “përdhunim gjatë një takimi njohjeje”	Shprehjen “përdhunim nga një i njohur”.
Termet “femra, meshkuj”	Termet “gruaja, vajza, nëna, bija, burri, djali”, etj.

- Ndërkohë që mund të jeni duke u përpjekur t'i përgjigjeni pyetjes “pse” ka ndodhur krimi, për të cilin po raportoni, mbani parasysh prirjen e një pjese të publikut për të fajësuar viktimën, gjë që përbën një shqetësim të madh për të mbijetuarat e dhunës seksuale dhe të dhunës në familje.
- Përshkrimi i dhunuesve si ‘përbindështa’ i bën ata të duken si diçka e huaj, e largët dhe mund t'i pengojë njerëzit që të raportojnë dyshimet që mund të kenë për dikë që ushtron dhunë, meqë njerëzit mund të mendojnë për dhunuesin, për të cilin kanë dyshime: “Ai është njeri i mirë, nuk është përbindësh.”
- Evitoni raportimin e përkatësisë etnike të dhunuesit ose të të mbijetuarës, nëse ky faktor nuk është një element kyç i ngjarjes, d.m.th., kur dhuna nuk ka ndodhur për hir të përkatësisë etnike të së mbijetuarës.
- Raportimi i shumicës së detajeve rreth viktimës/të mbijetuarës (mënyra e veshjes, pamja fizike dhe jeta private) mund:
 - Të çojë në fajësimin e viktimës nga një pjesë e publikut;
 - T'i japë audiencës suaj një ndjenjë të rreme sigurie se ai/ ajo nuk do të dhunohet për shkak se nuk vishet si viktimë, nuk ka të njëjtën jetë private, të njëjtat vese si ajo/ai, etj.;
 - Të dëmtojë viktimën e familjen e saj, sepse këto detaje mund të raportohen përpara se viktimë ose familja të vihet në dijeni për raportimin në media, për shkak të garës me gazetarë të tjerë që mund të raportojnë për të njëjtën ngjarje.
- Është shumë e rëndësishme që të zgjidhni me shumë kujdes fjalët që nuk krijojnë ndjenjën e fajit për viktimën/të mbijetuarën. Ja disa shembuj të detajeve që mund të keqinterpretohen, nëse paraqiten jashtë kontekstit të gjerë të ngjarjes, ose që dëmtojnë viktimat/të mbijetuarat:
 - Viktimë ishte e veshur në mënyrë provokuese dhe/ose ishte tërheqëse;
 - Nuk janë përdorur armë;
 - Viktimë nuk kishte lëndime fizike;
 - Viktimë ishte e re, por jo fëmijë;
 - Viktimë ishte prostitutë, ishte e dehur, ose e shoqëronte me dëshirë dhunuesin;
 - Viktimë ka kryer marrëdhënie seksuale me pëlqim me dhunuesin më parë.

- Kur raportoni mbi raste të dhunës në familje, përveç rekomandimeve të përmendura më lart,:
 - Kumtojani qartë audiencës suaj se bëhet fjalë për dhunë në familje, duke shmangur kategorizimin e ngjarjes si “mosmarrëveshje në familje”, “probleme në marrëdhënie”, ose ndonjë term tjetër që minimizon sjelljen e dhunshme.
 - Bëjani të qartë audiencës suaj se dhuna në familje është krim që dënohet me ligj dhe se kjo dhunë nuk është çështje private, por çështje e të drejtave të njeriut; flisni mbi pasojat e dhunës në familje, duke theksuar faktin që dhuna në familje ndikon tek fëmijët, sistemi shëndetësor, ekonomia, etj.
 - Shoqërojeni lajmin me informacion mbi shkallën e përhapjes së dhunës në familje (përdorni edhe statistika), ekzistencën e shërbimeve mbështetëse për ata që kryejnë dhe përjetojnë dhunën në familje, dhe përfshini intervista me ekspertë dhe specialistë të fushës.
 - Shmangni përdorimin e burimeve që kanë një marrëdhënie të ngushtë me personin që kryen dhunën, ose burime të keqinformuara mbi krimin apo ata që janë të përfshirë në të (shiko shembullin në faqen pasardhëse).
- Kur raportoni raste të dhunës seksuale, përveç rekomandimeve të përmendura më lart,:
 - Raportoni me saktësi natyrën e dhunshme të sulmit seksual (përdhunimi përfshin detyrimin fizik dhe/ose verbal) me sqarime të posaçme se si janë përdorur kërcënimet ose forca ndaj të mbijetuarës.
 - Mos raportoni vetëm pretendimet e përdhunuesit të akuzuar që thotë se e mbijetuara ka kryer marrëdhënie me pëlqimin e saj. Raportoni mbi dëshminë e të mbijetuarës, mbi mungesën e pëlqimit, ose sigurohuni që të keni informacion të konsiderueshëm nga avokati apo mbështetësit e saj. Nëse e mbijetuara është minorene, marrëdhënia seksuale më të është krim dhe çështja e pëlqimit nuk merret fare në konsideratë nga organet e drejtësisë.

- Shoqërojeni lajmin me informacion mbi shpeshhtësinë e dhunës seksuale (përdorni edhe statistika), duke vënë në pah se, shpesh, dhunuesi është një njeri i njohur për të mbijetuarën dhe jo një njeri i huaj. Kjo do ta ndihmojë publikun që të kuptojë faktin se shpesh dhuna seksuale ushtrohet nga njerëz që i njohim dhe që janë shumë afër nesh.
- Konsultohuni me ekspertët që merren me çështje të dhunës me bazë gjinore, sepse ata ju ofrojnë: (i) informacion të specializuar; (ii) një trajtim të thelluar të ngjarjes; dhe (iii) sugjerime në mënyrë që raportimi juaj mbi ngjarjen të mos rrisë rrezikun e abuzimit të mëtejshëm ose ndëshkimit të së mbijetuarës, familjes së saj ose të personave që po e ndihmojnë atë. Këta ekspertë janë të prirur për të bashkëpunuar me gazetarët, në mënyrë që të sigurohen se po mbrohen të drejtat e të mbijetuarës.
- Ngjarjet e raportuara në media mund t'i shoqëroni me kontaktet e organizatave lokale që mbështesin të mbijetuarat, dhe me kontaktet e ofruesve të shërbimeve për të mbijetuarat. Kjo i ndihmon të mbijetuarat, dëshmitarët, familjet e tyre dhe persona të tjerë që mund të kenë përjetuar ose janë prekur nga dhuna me bazë gjinore, që t'ju drejtohen këtyre organizatave për të marrë shërbimet e nevojshme.
- Është shumë e rëndësishme që, para se të transmetoni adresat e kontaktit të organizatave lokale që mbështesin të mbijetuarat dhe të ofruesve të shërbimeve për të mbijetuarat, të merrni pëlqimin e tyre për këtë gjë. Në këtë mënyrë, siguroheni që subjektet që ofrojnë shërbime për të mbijetuarat, nuk do të përballen me hakmarrje (përfshirë dhunën, kërcënimet e dhunës, etj.) nga dhunuesit apo persona të tjerë.

Shembull i përdorimit të burimeve që kanë një marrëdhënie të ngushtë me dhunuesin:

“Ekzekutimi i [X profesion]: Vëllai i F. K. [*shënim i autoreve*: dhunuesi] “S’e ndaloja dot ngjarjen, ia kthyen fëmijët kundër”. Në këtë intervistë, vëllai i autorit të vrasjes së F.H. [*shënim i autoreve*: viktima që humbi jetën si pasojë e kësaj dhune] u përpoq të shpjegonte se autori i krimit ishte njeri i mirë dhe ishte viktimë e gruas së tij, duke lënë të kuptohej se “ajo e detyroi ta vriste”. Gjatë intervistës, ai jep detaje se ajo [viktima] nuk ishte askush para se të martohej me të [vrasësin] dhe se ai e ndihmoi atë dhe familjen e saj për të pasur një jetë më të mirë. “Vëllai im ndërhyri, kështu që ajo mund të bëhej [X pozitë]. Pastaj ai investoi në arsimimin e saj. Ai e regjistroi për të studiuar në [X profesion] dhe e bëri atë [X profesion]. Ai investoi gjithçka për të. Ajo e fitoi punën si [X profesion] për shkak të tij dhe më pas u divorcua nga vëllai im dhe e ofendonte duke thënë “Çfarë do të bëj me të”.

Duke botuar këtë lloj interviste, ju ndihmoni dhunuesin ose të afërmit e tij që të tregojnë anën e tyre të historisë, dhe në shumicën e rasteve, ata fajësojnë viktimën, duke gjetur justifikime për dhunën në familje, dhe në këtë rast për vrasjen e saj. Viktima u vra dhe ajo nuk mund të ofrojë anën e saj të historisë, kështu që, pas kësaj interviste, publiku mund të fillojë të mendojë se viktima e meritonte dënimin nga “dhunuesi bujar”. Duke shmangur këtë lloj intervistash, ju shmangni ofrimin e justifikimeve për sjellje të dhunshme ose përforcimin e besimit të gabuar se viktima apo e mbijetuara ka një pjesë të fajit për dhunën që është ushtruar mbi të. Përkundrazi, gazetarët duhet t’u japin zë atyre që kanë përjetuar dhunën në familje. Një shembull i tillë është lajmi që lidhet me të njëjtin rast, i cili titullohej “Ekskluzive, fëmijët e F.H.: Babi na terrorizonte, kur ne qanim, ai qeshte”.

Intervista me të mbijetuar të dhunës me bazë gjinore

- Sigurohuni që i njihni problematikat që lidhen me dhunën me bazë gjinore dhe gjuhën e përshtatshme që duhet përdorur kur flisni për rastet e kësaj dhune.
- Jini të vetëdijsëm se ka mundësi që intervista juaj ta përsërisë traumatizimin e të mbijetuarës, ndaj ndiqni me kujdes reagimet e saj dhe ndërprisni intervistën menjëherë, nëse ajo e kërkon këtë gjë. Po ashtu, mbani parasysh se, në shumicën e rasteve, e mbijetuara mund të vuajë ende pasojat e traumës, duke përfshirë edhe përjetimin e pikëllimit apo zemërimit.
- Është mirë që një grua apo vajzë viktimë e dhunës me bazë gjinore të intervistohet nga një gazetare grua.
- Si rregull, është mirë që e mbijetuara të jetë e shoqëruar në intervistë nga një person i besuar, si, p.sh., një familjare apo shoqe, së cilës i beson, apo një mbrojtëse e të drejtave të të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore.
- Personi që ju vë në kontakt me të mbijetuarën:
 - Duhet të jetë i ndërgjegjshëm lidhur me ndikimin që mund të ketë raportimi në media tek e mbijetuara, si dhe të jetë i autorizuar që t'ju vërë në kontakt me të mbijetuarën;
 - Duhet të ketë siguruar paraprakisht pëlqimin me shkrim të së mbijetuarës për intervistën, pasi e mbijetuara ka demonstruar se i kupton të gjitha pasojat e mundshme, pozitive ose negative, të zbulimit të informacionit të saj dhe mund të shpjegojë saktësisht se si do të përdoret informacioni i saj.
 - E ka këshilluar të mbijetuarën se cilat informacione mund t'i ndajë me gazetarin gjatë intervistës dhe cilat informacione është mirë të mos vihen në dispozicion të publikut të gjerë.
 - Duhet të jetë i vetëdijsëm se ka persona që mund të shfrytëzojnë qëllimisht ose pa dashje disbalancën e pushtetit midis intervistuesit dhe të mbijetuarës, anëtarët e familjes ose komunitetit, e këta persona mund të ushtrojnë presion mbi të mbijetuarën për të treguar historinë e saj kundër vullnetit të saj.

- Nxiteni të mbijetuarën të caktojë ajo vendin, kohën dhe mënyrën e zhvillimit të intervistës, në mënyrë që të ndihet e sigurtë.
- Para intervistës, ju duhet të nënshkruani një marrëveshje të thjeshtë ku premtoni se do të hiqni nga intervista informacionin që e identifikon të mbijetuarën (emri, identiteti fizik dhe zëri). Ky rregull mund të mos zbatohet, vetëm në rast se e mbijetuara shprehimisht pranon ose kërkon që identiteti i saj të zbulohet, pasi është këshilluar me personat që e shoqërojnë ose e mbështesin atë.
- Duhet të nënshkruani, po ashtu, një marrëveshje se nuk do të raportoni mbi ofruesit e shërbimeve për të mbijetuarën ose OSHC që e ndihmojnë atë. Ky rregull mund të mos zbatohet, vetëm në rast se këto subjekte bien dakord me shkrim për të kundërtën.
- Jepini të mbijetuarës paraprakisht informacion të detajuar dhe të plotë mbi çështjet, për të cilat do të flisni me të, dhe duhet ta informoni atë plotësisht se si do të përdoret informacioni që do të mblidhni nga kjo intervistë.
- Mundohuni të bëni një bisedë në vend të një interviste, pasi kështu e mbijetuara do të ndihet më mirë. Vendosni tonin e bisedës duke shprehur keqardhjen për atë që i ka ndodhur, dhe shpresën se përcjellja e kësaj ngjarjeje përmes medias mund t'ju vijë në ndihmë viktimave të tjera.
- Informojeni të mbijetuarën paraprakisht se ajo nuk është e detyruar t'i përgjigjet çdo pyetjeje dhe se ka të drejtë t'i kërkojë intervistuesit ta kalojë një pyetje specifike, ose të bëjë një pushim, nëse intervista po e shqetëson.
- Shmangeni pyetjen 'përse', pasi kjo mund të shihet si përpjekje për ta fajësuar të mbijetuarën dhe mund lërë të kuptohet sikur e mbijetuara e ka provokuar disi incidentin. E mbijetuara nuk duhet të fajësohet kurrë për atë që i ka ndodhur, sepse nuk ka asnjë justifikim, në asnjë rrethanë, për dhunën me bazë gjinore.
- Bëni pyetje të hapura dhe pa dhënë gjykim, që e lejojnë të mbijetuarën të tregojë historinë e saj.

- Falenderojeni të mbijetuarën duke përmendur se dëshmia e saj do të bëjë që publiku ta kuptojë më mirë atë dhe, ndoshta, do të nxisë viktimat e tjera të dhunës me bazë gjinore që të kërkojnë ndihmë.
- Jepini të mbijetuarës adresat tuaja të kontaktit, në mënyrë që ajo të mund t'ju kontaktojë, nëse ka nevojë.
- Nëse është e nevojshme, jepni të mbijetuarës informacion rreth institucioneve dhe organizatave ku mund të drejtohet për ndihmë.
- Përveçse në rrethana shumë të rralla, gazetarët ose profesionistët e tjerë të medias duhet të shmangin çdo intervistë direkte me fëmijët. Nëse intervista është thelbësore për raportimin e ngjarjes, përveç zbatimit të të gjitha parimeve të përshkruara më sipër, kur bëhet fjalë për fëmijët, duhet të ndërmerren hapat e mëposhtëm:
 - Intervista nuk duhet të zhvillohet pa qenë i pranishëm një i rritur tjetër. I rrituri është zakonisht një prind, por mund të jetë edhe dikush tjetër që vepron në vend të një prindi, si, p.sh., një mësues, kujdestar ose dikush që punon për agjenci apo OSHC që mbrojnë fëmijët.
 - Ekziston rreziku që adoleshentët mund të gënjejnë ose të marrin një vendim të pamenduar për të dhënë intervistë, vendim për të cilin mund të pendohen më vonë. Personi që e shoqëron adoleshentën në intervistë, duhet të sigurohet se adoleshentja e kupton se si do të përdoret materiali i intervistës dhe duhet të vlerësojnë nëse adoleshentja në fjalë është plotësisht e informuar për të dhënë pëlqimin për intervistën. Në të vërtetë, sa më i rritur është fëmija, aq më e domosdoshme është që t'i shpjegohet imtësisht mënyra sesi do të përdoret materiali i marrë në intervistë dhe vetëm atëherë të lejohet të marrë një vendim nëse do ta japë atë intervistë.
- Kini kujdes në përdorimin e imazheve, pamjeve dhe fotografive për të ilustruar dhunën me bazë gjinore:
 - Si rregull, nuk rekomandohet t'ju bëni fotografi të mbijetuarave.

- Edhe kur e mbijetuara bie dakord që të fotografohet, nuk duhet të lejohen fotografi që bëjnë të mundur identifikimin e saj, sepse kjo e vë atë në rrezik abuzimi dhe/ose hakmarrjeje të mëtejshme. Ky rregull mund të mos ndiqet vetëm nëse e mbijetuara ka dhënë pëlqimin e saj me shkrim, në prani të një shoqëruesi. Edhe në këtë rast, qëndroni në kontakt me fotografët për të rishikuar dhe zgjedhur imazhe, për të sqaruar çdo informacion dhe për të diskutuar mbi përdorimin e mundshëm të fotografive.
- Çdo përdorim i imazheve duhet ta paraqesë të mbijetuarën në një mënyrë që e ruan dinjitetin e saj.
- Aty ku është e mundur, kur raportoni për dhunën me bazë gjinore përdorni imazhe që ilustrojnë një situatë të përgjithshme dhe jo imazhe që të çojnë tek identifikimi i një incidenti specifik të dhunës seksuale apo dhunës në familje.
- Nuk duhet të përdorni kurrë fotot apo imazhe të fëmijëve që kanë mbijetuar dhunën me bazë gjinore.

C. Burime të vlefshme

Dokumente të rëndësishme

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/eng.pdf

<https://www.crca.al/sites/default/files/publications/Deklarata%20Universale%20e%20te%20Drejtave%20te%20Njeriut%20%281948%29.pdf> (shqip)

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (ratifikuar nga Shqipëria në korrik 1996)

<http://www.qbz.gov.al/botime/permbledhese/Konventa%20Europiane%20per%20te%20Drejtat%20e%20Njeriut.pdf> (shqip)

Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW) dhe Protokolli Opsional (ratifikuar nga Shqipëria në nëntor 1993)

<http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw>

Konventa e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (ratifikuar nga Shqipëria në shkurt 2013)

<https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/text-of-the-convention>

<https://rm.coe.int/168046246b> (shqip)

Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore”

<https://www.shendetesia.gov.al/ligje-7/>

Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (ndryshuar me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, nr.10 329, datë 30.9.2010, 47/2018, datë 23.7.2018)

<https://www.shendetesia.gov.al/ligje-7/>

Ligji nr.10221, datë 4.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

<https://www.shendetesia.gov.al/ligje-7/>

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016 – 2020

<https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf>

Burra dhe Gra në Shqipëri (të dhëna vjetore)

<http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/barazia-gjinore/#tab3>

Burime ndërkombëtare

Udhëzime për raportimin mbi dhunën seksuale

<http://www.dartcenter.org/topic/sexual-violence>

Fushatë për eliminimin e seksizmit në media

<http://whomakesthenews.org/advocacy/end-news-media-sexism-by-2020>

“Mision i Mundur”: Manual për Avokim mbi Median dhe Përkatësinë Gjinore

http://cdn.agilitycms.com/who-makes-the-news/Imported/advocacy_toolkit/missionpossibleeng.pdf

Manual “Të Gjesh Balancën e Duhur: Barazia Gjinore në Gazetari”

<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000180707>

Institucione dhe OSHC lokale

Qendra Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje

qktvdhfhssh@gmail.com; redinela.azizaj@gmail.com;

Linja e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat

Rr. “Muhamet Gjolleša”, pall. 73/1, Tiranë

Numër Falas: **116 117**

+355 422 33408; linjakeshillimit@gmail.com;

www.hotlinealbania.org

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Rr. “Vaso Pasha”, pall. 12, shk. 1, apt. 1, Tiranë

+355 4 2 259 795; avokatore@albmail.com; www.qag-al.org

Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim

Rr. “Abdyl Frashëri”, pall.10/1, apt.3, shk.1, Tiranë
+355 42 255 514; gadc@gadc.org.al; www.gadc.org.al

Shoqata e grave “Refleksione”

Rruga e Elbasanit, pallatet “Fratari”, pallati “Tërshana”, Tiranë
+355 68 20 26 525; info@refleksione.org; www.refleksione.org

Streha për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara

Tiranë
edlira1960@yahoo.com

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN)

Rr. “Vaso Pasha”, pall. 16, apt. 2, Tiranë
+355 69 20 52 450; info@awenetwork.org;
www.awenetwork.org

Shërbimet Sociale “Bethany”

Rr. “Frederik Shiroka”, Pallati “Alba Konstruksion”, shk. 2, kati
2, Tiranë
bethanysocial@yahoo.com; www.bethany.org

Qendra Psikosociale “Vatra”

Rr. “Nermin Vlora Falaski”, pall. 13, shk. I, kati 3, Vlorë
+355 33 22 40 78; info@qendravatra.org.al;
www.qendravatra.org.al

Shoqata “Jona”

Rr. “Adem Sheme”, Sarandë
+355 85 222 425; jonaojq@yahoo.com; www.facebook.com/pg/ShoqataJona

Shoqata “Unë Gruaja”

Rr. “Kajo Karafili”, Pogradec
+355 83 222 140; une_gruaja@yahoo.com;
www.unegruaja.com

Gruaja te Gruaja

Lagjia “Vasil Shanto”, rr.“Marin Barleti”, nr. 161, Shkodër
+355 68 20 79 112; gruajatekgruaja@gmail.com;
www.gruajatekgruaja.com

Shoqata e Grave me Probleme Sociale

Lagja 2, rr. "Sefer Efendiu", prapa Prokurorisw së Rrethit Gjyqësor, Durrës
+355 52 234 600; shoqatagrave@yahoo.com;
qendraekeshillimit@yahoo.com; www.drejtesisociale.com

Forumi i Gruas

Lagja "5 Maj", rr. "Muç Shqiptari", pall. 450/1, Elbasan
+355 54 257 723; +355 54 254 516;
forumigruaselbasan1991@gmail.com;
www.forumigruaselbasan.org

Tjetër Vizion

Lagja "Aqif Pasha", rr. "Ali Arapi", nr.19, Elbasan
+355 54 252 919; tjetervizion@gmail.com; www.tjetervizion.org

Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem

Rr. "Vllazën Huta", shk 1, kati 8, apt. 39, Tiranë
+355 42 363 712; linjakeshillimit@gmail.com; www.clmb.al

Qendra Sociale "Hapa të Lehtë"

Rruga e Murgeshave, nr. 6, Shkodër
+355 22 241 316; qendragruashk@yahoo.com;
hapatelehte@gmail.com;
www.hapatelehte.org

Agritra Vision

Peshkopi
a-vizion@adanet.com.al; www.anrd.al

Zyra për Burra dhe Djem

Shkodër
+355 22 241 154; endrituligaj@yahoo.com

III. PËRFSHIRJA SOCIALE NË MEDIA

1. Aftësia e Kufizuar në Media

A. Koncepte bazë

Aftësia e kufizuar është një karakteristikë themelore e jetës në të gjitha vendet e botës. Ajo mund të jetë pjesë apo të ndikojë në jetën e gjithësecilit nga ne, në çdo moment dhe pavarësisht se cilës shtresë shoqërore i përkasim. Askush nuk është i mbrojtur dhe pothuajse secili nga ne mund të bëhet një person me aftësi të kufizuar në një moment të caktuar të jetës.

Njerëzit me aftësi të kufizuara përbëjnë afërsisht 1 miliard, ose 15 për qind të popullsisë së botës³. Familjarët dhe të afërmit e tyre përbëjnë 1.9 billion njerëz të tjerë. Së bashku, ato kontrollojnë mbi 9 trilion të të ardhurave të disponueshme globale⁴. Ndërkaq, njerëzit me aftësi të kufizuara janë një komunitet, i cili vuan shpesh nga diskriminimi e përjashtimi nga shërbimet themelore shëndetësore, arsimore, formimi profesional, si dhe nga mungesa e mundësisë për punësim dinjitoz. Si rezultat, njerëzit me aftësi të kufizuara kanë më pak mundësi për të marrë arsim cilësor, çka sjell më pak qasje në punësim, më pak të ardhura dhe, për rrjedhojë, norma më të larta varfërie në krahasim me njerëzit pa aftësi të kufizuara. Për më tepër, personat me aftësi të kufizuara, shpesh nuk kanë informacionin e duhur mbi kuadrin ligjor, politikat dhe shërbimet që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre. Kjo mungesë e njohurive e thellon edhe më tepër përjashtimin e tyre nga jeta shoqërore, ekonomike dhe politike. Egziston një lidhje e ngushtë midis varfërisë dhe aftësisë së kufizuar⁵: keqshqyerja, programe të pamjaftueshme imunizimi, aksidentet, stresi, ndotja e ambientit, etj., ndikojnë në shtimin e rasteve të personave me aftësi të kufizuara, sidomos në rastet e familjeve të varfëra. Nga ana tjetër, aftësia e kufizuar krijon një varfëri te tejskajshme për shkak të izolimit dhe vështirësive ekonomike, jo vetëm për personin konkret, por edhe për familjen e tij.

³ World Health Organization, World Bank 2011, World Report on Disability, WHO Press, Geneva.

⁴ Emerging Giant – Big is Not Enough. The Global Economics of Disability, March 1, 2012 (<http://tinyurl.com/lo89wea>).

⁵ Elwan, A., 1999, Poverty and disability. A survey of the literature. World Bank.

Edhe pse kemi të bëjmë me një treg potencialisht mjaft të fuqishëm, personat me aftësi të kufizuara janë gati të padukshëm në media, gati të harruar. Edhe kur flitet për ta, ndodh shpesh që çështjet që lidhen me këta njerëz, trajtohen në mënyrë fyese, diskriminuese apo poshtëruese. Mënyra se si media i portretizon personat me aftësi të kufizuara dhe frekuenca, me të cilën ata shfaqen në media, ndikojnë shumë në mënyrën se si shoqëria i trajton këta persona. Paraqitja e personave me aftësi të kufizuara me dinjitet dhe respekt në media kontribuon në krijimin e shoqërive më gjithëpërfshirëse dhe tolerante.

Media ka për detyrë të pasqyrojë në mënyrë të saktë, të vërtetë dhe të qartë realitetin e personave me aftësi të kufizuara, si dhe të ofrojë informacion në formate alternative, me qëllim që të sigurojë qasje në informacion edhe për personat me aftësi të kufizuar në dëgjim dhe shikim, si dhe për personat me aftësi të kufizuara intelektuale⁶ ⁷. Media duhet të jetë avokati më i mirë për integrimin në shoqëri të personave me aftësi të kufizuara duke pasqyruar pengesat e vështirësitë, me të cilat ndeshen ata, por edhe arritjet e tyre dhe të institucioneve dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e këtyre personave.

Të dhëna lidhur me personat me aftësi të kufizuara

- Rreth 15% e popullsisë së botës jeton me një formë të aftësisë së kufizuar;
- Në shumicën e vendeve, ka më shumë gra se sa burra me aftësi të kufizuar;
- Njerëzit me aftësi të kufizuar përbëjnë pakicën më të madhe në një shoqëri;
- 25% e rasteve të aftësisë së kufizuar janë rezultat i dhunës dhe i keqtrajtimit;
- Parashikohet rritje e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara gjatë 30 viteve të ardhshme, veçanërisht në vendet në zhvillim, për shkak të keqshqyerjes, sëmundjeve, të punës së fëmijëve, etj;
- 30% e fëmijëve të rrugës janë me aftësi të kufizuara (*të dhënat e mëlartme janë nga OBSH⁸*);
- 90% e fëmijëve me aftësi të kufizuara në vendet në zhvillim nuk ndjekin dot shkollën (UNICEF);
- Vetëm 3% e të rriturve me aftësi të kufizuara në të gjithë globin dinë të lexojnë dhe të shkruajnë (UNESCO);
- 80% e personave me aftësi të kufizuara që janë në moshë pune, janë të papunë (ILO);
- Në vendet me jetëgjatësi mesatare të popullsisë mbi 70 vjeç, çdo individ kalon mesatarisht 8 vite, d.m.th., 11.5 % të jetës së tij, me aftësi të kufizuara të përkohshme (UNDP).

⁶ VKM nr.483, datë 29 qershor 2016, "Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016-2020".

⁷ Ligji nr. 93/2014 datë 28.07.2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara".

⁸ FSHDPAK, 2016, Modul Trajnimi "Aftësia e Kufizuar dhe Barazia", Tiranë

Në Shqipëri çështjet që lidhen me aksesin, shërbimet sociale e shëndetësore, strehimin, formimin profesional e punësimin e personave me aftësi të kufizuara, janë tashmë të përfshira për zgjidhje në politikat qeveritare. Media mund e duhet të ndikojë në përshpejtimin e realizimit të këtyre të drejtave. Është gjithashtu shumë e rëndësishme që pasqyrimi në media i çështjeve të aftësisë së kufizuar të mos shihet i shkëputur nga problematikat e tjera shoqërore, duke përfshirë dhunën me bazë gjinore apo diskriminimin e personave LGBTIQ.

Persona me aftësi të kufizuara⁹: Janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Barierra: Janë pengesa, të cilat nuk lejojnë që personat me aftësi të kufizuar të jetojnë në mënyrë të pavarur, të punojnë, të udhëtojnë apo të kenë qasje në ndërtesa.

Braille: Është një sistem shkrimi dhe printimi për personat e verbër, i bazuar mbi një sistem pikëzimi.

Diskriminim: Është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në ligjin 'Për Mbrojtjen nga Diskriminimi', që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Ndër shkaqet e renditura në këtë ligj, është dhe aftësia e kufizuar.

Gjuha e shenjave: Është sistemi i shenjave me lëvizje duarsh që njihet dhe përdoret nga personat me aftësi të kufizuar në dëgjim dhe në të folur.

Jetesë e pavarur: Do të thotë që personat me aftësi të kufizuara kanë mundësinë për të zgjedhur vendin e tyre të banimit, ku dhe më kë do të jetojnë në baza të barabarta me të tjerët, dhe nuk janë të detyruar të jetojnë në një mënyrë të veçantë, ndryshe nga të tjerët.

⁹ Termat e paraqitur janë pjesë e Fjalorthit të Aftësisë së Kufizuar, botuar nga FSHDPAK, 2014, Tiranë.

Kujdestar ligjor: I referohet kujdestarit të një personi, të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar me vendim të gjykatës. Si rregull, kujdestari caktohet me pëlqimin e personit me aftësi të kufizuar.

Modeli mjekësor/Qasja mjekësore: Modeli mjekësor e shikon aftësinë e kufizuar si problem të personit, të shkaktuar në mënyrë të dejtëpërdrejtë nga sëmundja, trauma apo gjendja mjekësore, dhe që kërkon kujdes mjekësor të vazhdueshëm nga profesionistë të mjekësisë. Sipas modelit mjekësor, aftësia e kufizuar duhet të kurohet.

Modeli social/Qasja sociale: Modeli social e shikon aftësinë e kufizuar si problem shoqëror dhe çështje të integritit në shoqëri të personave me aftësi të kufizuar. Sipas këtij modeli, aftësia e kufizuar nuk është një cilësi e personit, por janë disa kushte dhe rrethana, shumë prej të cilave janë të krijuara nga ambjenti rrethues. Sipas këtij modeli, kërkohet ndryshimi i shoqërisë dhe është detyrim i saj të bëjë modifikimet e nevojshme, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të jenë pjesëmarrës në të gjithë fushat.

Modeli bio-psiko-social/Qasja bio-psiko-sociale: Modeli bio-psiko-social e paraqet aftësinë e kufizuar si një ndërveprim të gjendjes shëndetësore apo dëmtimit të individit me faktorët mjedisorë dhe ata personalë.

Pension invaliditeti: I referohet pensionit që merr një person me aftësi të kufizuara kur bëhet i paaftë për çdo veprimtari ekonomike apo kur ka gjymtime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin). Invaliditeti caktohet nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP).

Përfshirja sociale: I referohet përfshirjes në të gjitha aspektet e jetës politike, ekonomike dhe shoqërore të grupeve të disavantazhuara (personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit, të varfërit, personat LGBTIQ, pakicat etnike, personat që vuajnë nga HIV/SIDA, etj.), të cilat, si rregull, përjetojnë diskriminim e përjashtim nga shoqëria.

Përfshirje e çështjeve të aftësisë së kufizuar: I referohet përfshirjes sistematike të prioriteteve dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha politikat dhe masat, nga faza e planifikimit, përgjatë zbatimit e monitorimit dhe deri në vlerësim.

Sisteme/aparate të dëgjimit: Janë pajisje që multiplifikojnë tingujt ose zërin, në mënyrë që të ndihmojnë personat me aftësi të kufizuar në dëgjim.

Shkollë speciale: Janë shkolla të posaçme për fëmijë me aftësi të kufizuara, kryesisht me aftësi të kufizuar mendore, por edhe forma të alternuara të aftësisë së kufizuar mendore dhe asaj fizike. Këto shkolla funksionojnë në bazë të kurrikulave të veçanta.

Terapi okupacionale: Është një shërbim profesional shëndetësor i fokusuar tek personat me aftësi të kufizuar dhe që ka për qëllim kryesor promovimin e shëndetit të këtyre personave përmes zënies me punë të tyre. Qëllimi kryesor i terapisë okupacionale është që të bëjë të mundur që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në aktivitetet e jetës së përditshme.

B. Raportimi

Raportimi mbi çështje të aftësive të kufizuara

- Raportimi juaj mbi personat me aftësi të kufizuara dhe jetën e tyre duhet të bëhet sipas modelit social, të bazuar në të drejtat e njeriut. Duhet shmangur mëshirimi që fokusohet tek dhimbja dhe keqardhja që ngjall situata e një personi me aftësi të kufizuara.
- Raportimi mbi çështjet kolektive të aftësisë së kufizuara duhet të jetë sa më gjithëpërfshirës, në mënyrë që kronika/intervista juaj t'i vlejë një numri sa më të madh personash. Qëllimi juaj duhet të jetë që t'i trajtohet problematikat që lidhen me aftësinë e kufizuara, në mënyrë të tillë që publiku apo autoritetet përgjegjëse që e dëgjojnë, të mund të ofrojnë një zgjidhje.
- Raportimi personat me aftësi të kufizuara duhet kryer pa cënuar apo diskriminuar këtë grup shoqëror dhe duke theksuar me realizëm përpjekjet e sukseshme në politikë-bërje apo legjislacion që kanë çuar në përmirësimin e jetës së këtij grupi.
- Paraqitini personat me aftësi të kufizuara si njerëz normalë, si pjesë integrale e shoqërisë. Në shumicën e rasteve, media i portretizon persona me aftësi të kufizuara ose si heronj, ose si viktimë. Ata viktimizohen dhe nuk paraqiten si qenie reale, me dritëhijet e tyre. Në disa raste, media i paraqet këta persona sikur të kenë bërë çudira, sikur janë “supermen”, me shumë madhështi, me aftësi të mrekullueshme. Ose i paraqet ata si shumë vulnerabël, të harruar nga shoqëria, të izoluar, të braktisur, pa asnjë mundësi.
- Shmangiuni paraqitjes së personave me aftësi të kufizuara në një mënyrë të kufizuara dhe që e përforcon izolimin e tyre. P.sh., në shumë programe të formatit talkshow njerëzit me aftësi të kufizuara ftohen vetëm që të flasin për çështje të personave me aftësi të kufizuara. Por, shumë prej personave me aftësi të kufizuara janë specialistë në fusha të ndryshme dhe ata mund të ftohen të japin ekspertizë dhe mendime profesionale. Gazetarët dhe skenaristët e harrojnë këtë përmasë të personave me aftësi të kufizuara dhe i paraqesin thjesht si grup interesi, i cili ka disa nevoja e probleme për t'u zgjidhur ose spektakularizohen për të ngjallur mëshirën ose habinë e shikuesit apo lexuesit.

- Si njerëz të medias, ju mund të luani një rol të rëndësishëm në promovimin, por edhe në përmirësimin e politikave dhe programeve kombëtare në shërbim të personave me aftësi të kufizuara. Ato mund të ndihmojnë në rritjen e vizibilitetit të një komuniteti, i cili është i përjashtuar dhe i marginalizuar. Ju mund të ndihmoni duke rreitur shkallën e ndërgjegjësimit të publikut për ligje dhe politika që prekin jetën e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu edhe dokumentat bazë ndërkombëtare të fushës.
- Si njerëz të medias, ju mund të ndikoni që publiku t'i kuptojë drejt çështjet e aftësisë së kufizuar dhe, kështu, të kontribuoni në tejkalimin e pengesave që personat me aftësi të kufizuara hasin në arsimim, punësim, shërbime, informacion, sepse hapi i parë drejt eliminimit të barrierave është ndryshimi i perceptimit që personat me aftësi të kufizuara janë 'të paaftë' dhe 'të pavlerë'.
- Si njerëz të medias, ju duhet të informoheni dhe të trajtoni me kujdes çështjet e aksesueshmërisë^{10 11}, për personat me aftësi të kufizuara. E gjithë shoqëria përfiton kur personat me aftësi të kufizuar në shikim, mund të votojnë duke përdorur një fletë votimi me sistemin Braille; kur fëmijët me çrregullime të spektrit të autizmit (në spektrin që e bën të mundur mësimin në shkolla të zakonshme) mund të hyjnë në një klasë e të mësojnë krahas bashkëmoshatarëve të tyre, me përkrahjen e një ndihmës-mësuesi të specializuar për t'i ndihmuar ata; kur njerëzit me aftësi të kufizuar fizike që përdorin karrocë me rrota, mund të paraqiten në një zyrë shtetërore për të punuar apo për të kërkuar një shërbim, etj.

Mbani parasysh! Mediat dhe personat me aftësi të kufizuara mund të bëhen bashkëpunëtorë të mirë me njeri-tjetrin. Media ka interes të marrë informacion dhe ta pasqyrojë lajmin, të gjejë personazhe interesante, ta bejë gazetën të shitshme dhe kronikën të shikueshme. Ndërsa personat me aftësi të kufizuara duan ta bëjnë të dukshme problematikën e tyre dhe të bëhen të njohur për publikun, kur arrijnë diçka. Kështu, të dyja palët mund të bashkërendojnë interesat e tyre e t'i shërbejnë kauzës së njëri-tjetrit, pa çenuar atë që kanë përballë.

¹⁰ Ligji nr. 93/2014 datë 28.07.2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".

¹¹Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ratifikuar nga qeveria shqiptare me Ligjin nr.108/2012.

Nëse personat me aftësi të kufizuara nuk do të kenë akses në mjedise, në transport, në informacion dhe në komunikim, si dhe në lehtësirat dhe shërbimet pranë komuniteteve ku ato jetojnë, ata asnjëherë nuk do të ndihen të përfshirë dhe pesha e shërbimeve për ta do të jetë më e madhe e do të bjerë gjithnjë e më shumë mbi shpatullat e familjes së tyre ose të personave kujdestarë për ta.

Parime etike kur trajtohen çështjet e aftësisë së kufizuar¹²

- Gazetari është përgjegjës për saktësinë e informacionit dhe efektet e tij në jetën shoqërore. Informacioni, që ka të bëjë me personat me aftësi të kufizuara, duhet të jetë korrekt, i plotë dhe jo spekulativ. Nuk lejohet shtrembërimi apo falsifikimi i materialit gjatë përpunimit, redaktimit apo vendosjes së diçiturës së fotos.
- Gazetari duhet t'i citojë të gjitha palët pjesëmarrëse në një ngjarje. Në rastin kur kemi të bëjmë me persona me aftësi të kufizuara që nuk janë të aftë për të dhënë një opinion në lidhje me një ngjarje, gazetari duhet të citojë personin që ka të drejtën juridike për përfaqësimin publik të personit me aftësi të kufizuara, për të cilin bëhet fjalë.
- Askush nuk ka të drejtë ta përdorë informacionin për personat me aftësi të kufizuara për të dëmtuar imazhin e tyre publik. Bërja publik e informacionit, duhet të jetë i autorizuar nga vetë personat me aftësi të kufizuara ose nga personi që ka të drejtën juridike për ta bërë këtë gjë.
- Jeta intime e personave me aftësi të kufizuara, ashtu si dhe jeta intime e çdo qytetari, është e shenjtë. Asnjë gazetar nuk duhet të bëjë publike të dhëna apo foto nga jeta private e një individi pa autorizimin e personave që kanë lidhje me të dhënat e publikuara. Bërja publike e të dhënave dhe fotove nga jeta private e personave me aftësi të kufizuara, nuk mund të bëhet as në rastin kur kjo është në favor të interesave madhore të publikut.

¹² FSHDPAK, 2004, Kodi i Etikës mbi Median dhe Aftësinë e Kufizuar, Tiranë

- Stereotipet sociale për disa kategori të aftësisë së kufizuar mbështeten mbi paragjykime dhe dëmtojnë personat me aftësi të kufizuara. Gazetarët duhet t'i trajtojnë personat me aftësi të kufizuara duke evituar stereotipet e krijuara dhe kjo nënkupton një trajtim objektiv të tyre. Personat me aftësi të kufizuara janë qytetarë të vendit, me të drejta të barabarta me të tjerët, dhe duhen trajtuar si të tillë.
- Ndalohet kategorikisht përdorimi i termave fyes dhe i fjalorit diskriminues për personat me aftësi të kufizuara. Është e këshillueshme që gazetarët të përdorin terminologjinë që paraqitet në këtë Guidë.
- Imazhet televizive nuk duhet të fokusohen në pjesët e dëmtuara të personave me aftësi të kufizuara, nëse këtë nuk e autorizon personi i filmuar. Fokusimi në pjesë të dëmtuara të trupit nuk duhet të jetë qëllim i pamjeve televizive.
- Personat me aftësi të kufizuara ose shfaqje që vijnë si rrjedhojë e një dëmtimi nuk duhet të shërbejnë si objekte humori për kategoritë e tjera sociale.
- Është kategorikisht i ndaluar përdorimi i imazheve të personave me aftësi të kufizuar për spote publicitare apo reklama. Kjo mund të realizohet vetëm me kërkesën dhe pëlqimin e vete personit me aftësi të kufizuara ose të personit që ka të drejtën juridike për ta bërë këtë, duke e trajtuar këtë situatë në mënyrë shumë të kujdesshme.
- Ndalohet botimi i shkrimeve dhe transmetimi i lajmeve që nxisin qëndrime diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara.
- Organet e medias nuk duhet të botojnë materiale identifikuese për personat me aftësi të kufizuara, në rastin kur këto materiale vështirësojnë jetën e personit me aftësi të kufizuar ose rëndojnë pozitën e tij shoqërore.
- Problemet shëndetësore të njerëzve me aftësi të kufizuara nuk duhet të përdoren si mjet për portretizimin publik të tyre. Personat me aftësi të kufizuara nuk duhen trajtuar si individë të ndryshëm, pavarësisht dëmtimit që kanë pësuar.

- Problemet e personave me aftësi të kufizuara dhe ndjeshmëria e publikut nuk duhet të përdoren në mënyrë abuzive për qëllime komerciale. Titujt e lajmeve dhe të artikujve që kanë në qendër të vëmendjes persona me aftësi të kufizuara, duhet të jenë përfaqësues, të saktë dhe korrektë nga pikëpamja etike.
- Mediat duhet t'ju ofrojnë personave me aftësi të kufizuar akses në media përmes realizimit të transmetimeve të veçanta për persona me aftësi të kufizuara në dëgjim apo shikim (p.sh., duke transmetuar lajmet edhe në gjuhën e shenjave), në mënyrë që kjo kategori të marrë informacionin e nevojshëm në çdo aspekt.

Ndërveprimi me persona me aftësi të kufizuara

- Ndërveprimi me personat me aftësi të kufizuara nuk kërkon aftësi të veçanta, po duhet të jetë njëlloj si kur ndërveproni me një person pa aftësi të kufizuara.
- Përpara se të raportoni për ngjarje apo çështje që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara, informohuni dhe mësoni rreth këtyre çështjeve. Përmes një kërkimi fillestar në internet mund të lexoni artikuj apo të ndiqni kronika lidhur me tematikën konkrete. Kjo do t'ju japë një panoramë më të qartë për atë që ka ndodhur më parë në këtë fushë, si dhe do t'ju ndihmojë të vini kontakte apo të zhvilloni takime me persona që janë ekspertë të fushës, përpara se të realizoni intervistën apo kronikën.
- Gjatë intervistës apo kronikës, duhet të mbani parasysh disa rregulla etike në lidhje me ndërveprimin me personat me aftësi të kufizuara.
 - Personat me aftësi të kufizuara duhet të njihen paraprakisht me pyetjet, për të cilat doni të merrni informacion, për të marrë miratimin e tyre nëse janë dakort me fushat që do të trajtohen.
 - Nëse është një reportazh i fokusuar tek historitë personale të personave me aftësi të kufizuara, duhet që fokusi më i madh të jetë tek arritjet e individit dhe mënyra se si bashkëjeton ai me mjedisin. Lajmi apo reportazhi nuk duhet fokusuar domosdoshmërisht tek

dëmtimi i personit me aftësi të kufizuar, si ka ndodhur ai, apo tek dhimbja dhe trishtimi që ka shkaktuar kjo situatë në atë periudhë të jetës së personit.

- Sigurohuni që personin me aftësi të kufizuar e paraqisni në mënyre dinjitoze dhe jo “të përvuajtur” që të ngjallë mëshirë tek të tjerët. E gjitha kjo do të krijojë tek shikuesi apo lexuesi idenë se këta persona, pavarësisht vështirësive, kanë dinjitet dhe përpiqen ta ruajnë atë.
- Pyeteni personin me aftësi të kufizuara, me të cilin po flisni, për gjithçka që ju jeni i/e pasigurt;
- Shiheni personin me aftësi të kufizuara në sy kur flisni me të, pavarësisht se mund të jetë duke përkthyer një përkthyes i gjuhës së shenjave (kur është një person me aftësi të kufizuar në shikim) apo mund të jetë i shoqëruar nga kujdestari;
- Gjithmonë drejtojani komentet, pyetjet dhe shqetësimet direkt personit me aftësi të kufizuara (edhe kur është një person që nuk dëgjon apo shikon), me të cilin po komunikoni;
- Përdorni tonin tuaj normal dhe mos bërtisni kur flisni me një person që nuk dëgjon apo nuk shikon;
- Mos shprehni ndjenja të keqardhjes ndaj personit me aftësi të kufizuar, me të cilin po flisni, apo për persona të tjerë me aftësi të kufizuar;
- Kur jeni duke komunikuar me një person me aftësi të kufizuara në shikim, është shumë e rëndësishme të identifikoni veten kur i afroheni atij dhe t’i tregoni atij, kur vendosni të largoheni nga biseda apo ambjenti;
- Ofroni ndihmë, duke pyetur me parë personin me aftësi të kufizuar, nëse ka nevojë për të;
- Nëse personi me aftësi të kufizuar kërkon ndihmë ose e pranon ofertën tuaj për ndihmë, i lejoni personit me aftësi të kufizuar t’ju drejtojë ai, kur e ndihmoni gjatë lëvizjes. Mos shtyni ose mos e tërhiqni personin apo pjesë të trupit të tij dhe mos u përpiqni t’i udhëhiqni ata.

Terminologjia e përshtatshme

Terminologjia¹³ që përdorni kur flisni për aftësinë e kufizuar, luan një rol shumë të rëndësishëm në mënyrën se si shoqëria i shikon dhe i trajton personat me aftësi të kufizuara. Ajo është, po ashtu, shumë e rëndësishme, kur ndërveproni me personat me aftësi të kufizuara.

Përdor	Mos përdor
Përdor gjithmonë fjalën 'person' përpara	Mos përdor terma që etiketojnë
Person/ individ me aftësi të kufizuara Person që ka një dëmtim	Handikapat
Persona pa aftësi të kufizuara	Person normal Individ i shëndetshëm Pa dëmtim në trup
Person me vështirësi në të mësuar Person me aftësi të kufizuara mendore/ intelektuale Person me sindromën daun (down) Person me aftësi të kufizuara psiko-sociale	Është me zhvillim të vonuar mendor Është i vonuar/I vonuari Është daun (down), mongoloid; Handikapat mendor Person me probleme mendore
Person me çrregullime të spektrit të autizmit	Autist
Person që vuan nga ADHD	Ai/Ajo është me çrregullim hiperaktiv të vëmendjes.
Person me vështirësi në komunikim, vështirësi në të folur/ person që nuk flet	Nuk artikulon; gagaç
Person me vështirësi në dëgjim ose me humbje të dëgjimit	Shurdh
Person me dëmtim në shikim; Person i verbër Person me shikim të pjesshëm;	Ai që nuk shikon; qorri
Person që ka epilepsi	Epileptik
Person që përdor karrige me rrota Person që ka dëmtim në lëvizje	I paralizuar I destinuar për të qëndruar në karrige me rrota
Person me tetraplegji/paraplegji	Tetraplegjiku/Paraplegjiku
Person me trup të shkurtër	Shkurtabiq
Person me një aftësi të kufizuar të lindur	Ka difekt në lindje
Autobuzë të përshtatur; tualete të përshtatura, dhoma hotelesh të përshtatura, etj. Vend parkimi i përshtatur për persona me aftësi të kufizuara	Autobuzë, tualete dhe dhoma hotelesh për handikapatë; Vende parkimi për handikapatë.

¹³ FSHDPAK, 2016, Modul Trajnimi "Aftësia e Kufizuar dhe Barazia"

C. Burime të vlefshme

Dokumente të rëndësishme¹⁴

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin nr.108/2012)
<https://www.un.org/development/desa/disabilities/convention-on-the-rights-of-persons-with-disabilities.html>

Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDGs) të OKB-së
<https://sustainabledevelopment.un.org/sdgs>
<https://sustainabledevelopment.un.org/memberstates/albania>

Ligji nr.10221, datë 4.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
<https://www.shendetesia.gov.al/ligje-7/>

Ligji nr. 93/2014, datë 28.07.2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.

Ligji nr.121, datë 21.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
<https://www.shendetesia.gov.al/ligje-7/>

Ligji nr. 69 / 2012, “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit” (i ndryshuar), Neni 15 “Detyrimet e punëdhënësit për të punësuar personat me aftësi të kufizuara”.

VKM nr.483, datë 29 qershor 2016, “Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016 - 2020”.

VKM nr. 1071, datë 23.12. 2015, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, 2015 - 2010”.

VKM nr. 87, datë 3.2.2016, “Për miratimin e Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale, 2016 – 2020”.

¹⁴Për dokumentat, për të cilat nuk është vendosur një adresë në internet, mund të kontaktoni Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mirëqenies Sociale.

VKM nr.708, datë 26.8.2015, “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”.

VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

VKM Nr.405, datë 1.6.2016, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Strehimit Social, 2016 - 2025”.

OSHC lokale

Shoqata Kombëtare në Ndihmë të Handikapëve Mendore

Rr. “A. Moisiu”, pranë Kinostudios, Tiranë
+355 68 20 84 945; centervduka@albmail.com

Shoqata Kombëtare e Para- dhe Tetraplegjikëve

Rruga e Durrësit, Ish-Uzina “Enver”, Tiranë
para_tetra@yahoo.com

Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë; +355 69 20 37 439;
+355 22 50 325; ship@abissnet.com.al

Shoqata Kombëtare e të Verbërve

Rruga “Nikolla Lena”, nr. 62, Tiranë;
+355 422 59 611; +355 68 21 80 96; stafaj@yahoo.com;
www.shvsh.org.al

Shoqata “Ndihmoni Jetën“

Qendër ditore e shërbimeve sociale dhe advokaci për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara;
Fshati Prush, Vaqarr, Tiranë
+355 44 80 33 70; +355 68 20 82 190, +355 68 20 84 994,
+355 68 20 82 190; aferditaseiti@helphelife.org.al;
<http://www.helphelife.org>

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Rruga “Bogdani”, nr 1, Tiranë
+355 422 69 426; adrf@albmail.com

MEDPAK - Shoqata në Mbrojtje të të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara

Librazhd dhe Tiranë
medpak@albmail.com; zelakoka@gmail.com;
<http://medpak.org>

ANAD - Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që Nuk Dëgjojnë

Mob: (text only) + 355 68 31 86 043; www.anad.al;
anad.coordinator@gmail.com;

Down Syndrome Albania

Integrim i plotë në shoqëri për individët me sindromën Down
Tiranë, +355 67 48 85 864; e_zaimi@dsaalbania.org;
<https://dsalbania.org/>

Qendra Jonathan

Aftësimi i fëmijëve me sindromën Down për një jetë të pavarur
Rruga e Kavajës, nr. 175, Tiranë
+355 68 20 19 727; info@downsyndromealbania.com;
www.downsyndromealbania.com

Disabled People Active Albania

Punon për fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara, përmes aktiviteteve sportive.
+355 68 200 0324; info@adp-al.org; bledi_suxha@gmail.com

2. Personat LGBTIQ në Media

A. Koncepte bazë

Personat LGBTIQ kanë qenë pjesë e shoqërisë njerëzore që në krijimet e veta. Ata janë anëtarë të shoqërisë njerëzore me të drejta dhe kontribute të plota, si të gjithë të tjerët, dhe janë të vendosur në një pjesë të caktuar të spektrit të gjerë se si njerëzit e jetojnë dhe e përjetojnë seksualitetin e tyre¹⁵. Disa nga figura më të shquara të shkencës, politikës, ekonomisë, kulturës dhe artit në botë kanë qenë dhe janë persona LGBTIQ.

Pavarësisht se në Shqipëri egzistojnë dispozita ligjore që mbrojnë personat LGBTIQ nga diskriminimi dhe ndalojnë gjuhën e urrejtjes ndaj tyre në të gjitha fushat, përfshirë dhe edukimin parauniversitar, përvoja tregon se në vendin tonë ende mbizotëron pabarazia dhe mungesa e të kuptuarit dhe e respektimit të të drejtave të njeriut të personave LGBTIQ. Sipas studimit¹⁶ “Perceptimet e opinionit publik ndaj komunitetit LGBTI”, 48% e popullsisë në Shqipëri mendon se homoseksualiteti është sëmundje. Individuati e komunitetit LGBTI¹⁷ shpesh ndihen të detyruar ta fshehin orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor nga ata që i rrethojnë, duke përfshirë familjen, miqtë dhe komuniteti ku jetojnë. Sipas Institutit Danez për të Drejtat e Njeriut¹⁸, individët transgjinorë, veçanërisht ato gra, ka gjasa të bien më shpesh pre e dhunës. Shumë shpesh sulme dhune ndaj këtij komuniteti, si dhe raste të dhunës apo talljeje nga policë të caktuar nuk raporohen në institucionet përgjegjëse.

Si kudo në botë, situata e personave LGBTIQ në Shqipëri rezulton të jetë më e mirë në qytete të mëdha të vendit se sa në periferi të qyteteve të mëdha apo në zona rurale. Ndaj, ka një tendencë të të rinjve LGBTIQ që të zhvendosen drejt qyteteve të mëdha, me qëllim që të gjejnë mbështetje në persona, grupime apo komunitete në situatë të ngjashme, si dhe të kenë më shumë siguri, mundësi punësimi, mjedis fizik dhe kulturor më përfshirës.

¹⁵ Lexo më shumë në <https://www.britannica.com/topic/homosexuality>

¹⁶ NDI (2016), LGBTI Public Opinion Poll for Western Balkans

¹⁷ Intervista me drejtues të Aleanca kundër Diskriminimit të Personave LGBTI.

¹⁸ Danish Institute for Human Rights (2010), Study on Homophobia, Transphobia, and Discrimination on Grounds of Sexual Orientation and Gender Identity Sociological Report: Albania

Ofruesit e shërbimeve, të cilët vendosin edhe kontaktet e para me publikun në fushat e shëndetit, arsimit, zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit, jo gjithnjë e kuptojnë apo e vlerësojnë bazën legislative dhe zbatimin e saj në rastin e personave LGBTIQ. Referuar një studimi¹⁹ mbi situatën aktuale të perceptimeve të zyrtarëve publikë në nivel të qeverisjes vendore në gjashtë qytete të vendit lidhur me çështjet LGBTIQ, ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” praktikat kundër diskriminimit dhe për trajtimin e barabartë, rezultoi se: 12.9% e të intervistuarve nuk kishin informacion mbi personat LGBTIQ; 15.2% kishin marrë informacion prej trajnimeve dhe seminareve; 75.1 % thanë se nuk janë trajnuar asnjëherë mbi këtë temë dhe mbi 60% thanë se do të donin të trajnoheshin për këto çështje.

Personat LGBTIQ kanë të drejtë që media të raportojë në mënyrë të drejtë dhe gjithëpërfshirëse mbi historitë e jetës dhe shqetësimet e tyre. Media duhet t'i trajtojë personat LGBTIQ me paanshmëri, integritet dhe respekt, sepse ata janë si të gjithë anëtarët e tjerë të shoqërisë. Ende sot, pavarësisht përparimeve të bëra, ekzistojnë trajtime të diferencuara nga media të seksioneve të ndryshme të komunitetit LGBTIQ.

Orientim seksual²⁰: I referohet tërheqjes seksuale së natyrshme, prirjes ose aftësia për të zhvilluar marrëdhënie intime emocionale ose seksuale me njerëz që i përkasin kategorisë të së njëjtës gjini, gjinisë së kundërt apo më shumë se një gjinie.

Identitet gjinor: Është mënyra se si një individ vetidentifikohet me një kategori gjinore, si, p.sh., të jesh burrë ose grua, apo në disa raste asnjë prej tyre. Identiteti gjinor mund të jetë i dallueshëm nga seksi biologjik. Një person mund të ketë përputhshmëri me identitetin e tij gjinor (p.sh., karakteristikat fizike seksuale dhe identiteti gjinor i tij/saj janë në përputhje të plotë) ose mund të jetë një person transgjinor (ka lindur biologjikisht me një gjini, por emocionalisht ose shpirtërisht i përket një gjinie tjetër) ose mund të mos jetë plotësisht në asnjërën nga këto dy kategori.

¹⁹ Ambasada PINK (2016), “Perceptimet e punonjësve vendorë mbi shërbimet miqësore ndaj personave LGBTI”.

²⁰ Aleanca kundër Diskriminimit të Personave LGBT, 2018.

Strejt (Straight): Ju referohet personave që nuk identifikohen si persona LGBTIQ. Termi shkencor është ‘heteroseksualë’.

Gej (Gay): Ka zëvendësuar gjerësisht fjalën ‘homoseksual’, kur ju referohemi meshkujve që janë seksualisht dhe emocionalisht të tërhequr nga meshkuj të tjerë.

Lesbique: Është term i preferuar që mund të përdoret si emër ose mbiemër për gra dhe vajza që janë emocionalisht dhe seksualisht të tërhequra nga gra dhe vajza të tjera.

Biseksual: Ju referohet individëve që tërhiqen emocionalisht dhe seksualisht nga burrat dhe gratë. Kjo nuk do të thotë se këta persona janë detyrimisht dhe gjithmonë poligamë (d.m.th., kanë raport seksual të formalizuar me më shumë se një partner në të njëjtën kohë). Disa njerëz vetidentifikohen si ‘bi’ në vend të ‘biseksualë’.

Transgjinator: Është termi që preferohet nga individë, pamja, karakteristikat ose sjelljet e të cilëve nuk përshtatet me rolet gjinore tradicionale. Personat transgjinatorë mund të jenë strejt, gej, lesbique ose biseksualë. Disa individë vetidentifikohen si ‘trans’ më shumë se si ‘transgjinatorë’.

Interseks: Është një term që përdoret për të shënuar një sërë gjendjesh të personave që kanë lindur me karakteristika fizike seksuale dhe riprodhuese që nuk përpunohen plotësisht me përcaktimet tipike të karakteristikave fizike seksuale dhe riprodhuese të një mashkulli apo të një femre.

LGBTIQ: Është shkurtim për **l**esbique, **g**ej, **b**iseksualë, **t**ransgjinatorë, **i**ntersex dhe ‘të pavendosur’ (**q**uestioning).

I/e mbyllur në sirtar (Closeted): I referohet një personi që e mban të fshehur orientimin e tij/saj seksual ose identitetin gjinor.

Dalja hapur (Coming out): I referohet procesit që kalon një person LGBTIQ kur e kupton, ndërgjegjësohet dhe e pranon orientimin e tij/saj seksual ose identitetin gjinor dhe pastaj e ndan këtë informacion me të tjerët. Fillimisht, shumë të rinj LGBTIQ ngrejnë barrierë emocionale në raport me të njohurit e tyre, miqtë dhe familjarët, duke pretenduar (konkretisht ose nëpërmjet heshtjes) se janë strejt. Dalja hapur zakonisht ndodh me etapa dhe nuk është një proces që zhvillohet në vijë të drejtë.

Homofobia: I referohet frikës së paarsyeshme ndaj personave LGBTIQ, diskriminimit të këtyre personave për shkak të orjentimit të tyre seksual dhe sjelljes së tyre.

Homofobia e brendësuar (e interiorizuar): I referohet homofobisë dhe shtypjes që përjetojnë personat LGBTIQ dhe strejt, të cilëve mendojnë se heteroseksualiteti është normë dhe “mënyra e saktë e të egzistuarit”. Personat LGBTIQ në disa raste i bëjnë të tyret mesazhet negative që pjesa tjetër e shoqërisë projekton ndaj tyre. Disa persona LGBTIQ vuajnë nga shqetësime psiko-sociale si rezultat i homofobisë së brendësuar.

Transeksual: I referohet personave që kanë biologjikisht një seks (në lindje), por emocionalisht dhe shpirtërisht identifikohen me seksin tjetër. Transeksualët femër-mashkull (FTM) janë individë që kanë lindur femra, por identifikohen si meshkuj. Transeksualët mashkull-femër (MTF) kanë lindur meshkuj, por identifikohen si femra.

Queer (lexohet ‘kuiër’): Është një fjalë që njerëzit e përdorin për të përshkruar identitetin e tyre gjinor, i cili nuk konformohet me standartet sociale dhe me normat tradicionale të gjinisë. Queer mund të vetëquhen personat LGBTIQ ose streit.

Parada e Krenarisë (ose Parada Gej): I referohet një aktiviteti publik, në të cilin komuniteti LGBTIQ dhe mbështetësit e tyre parakalojnë për të shprehur krenarinë e të qenit LGBTIQ. Këto parakalime kanë shpesh formën e një feste, por, në mjaft raste, ato janë thjesht parakalime simbolike për të kërkuar të drejtat e mohuara të komunitetit LGBTIQ.

Bulizmi: I referohet fjalëve, sjelljeve dhe qendrimeve që kanë synim të dëmtojnë, të frikësojnë apo të detyrojnë dikë që perceptohet si njeri me dobësi, të bëjë gjëra kundër dëshirës së tij/saj. Personat LGBTIQ dhe sidomos fëmijët dhe të rinjtë LGBTIQ janë shpesh objekt i bulizimit në shkollë, në familje dhe në mjedise publike.

B. Raportimi

- Përpara se të raportoni për çështje të personave LGBTIQ, merrni njohuri për këtë fushë, për problemet, me të cilat këta persona përballen, dhe për termat që do të përdorni si për shembull 'gej', 'lesbikë', 'biseksual'.
- Mos prodhoni dhe mos përhapni asnjë material që ushqen urrejtjen dhe diskriminimin mbi bazë të orientimit seksual apo identitetit gjinor.
- Mos e përmendni orientimin seksual dhe identiteti gjinor të një personi LGBTIQ, nëse ato nuk kanë të bëjnë me ngjarjen, për të cilën po raportoni. Zbulimi në publik i orjentimit seksual të një personi LGBTIQ mund të shkaktojë trauma të rënda për të dhe për të afërmit e tij/saj, si dhe mund të çojë deri në vënien në rrezik të jetës së tij/saj nga persona homofobikë.
- Kur raportoni për ngjarje që lidhen me komunitetin LGBTIQ dhe të drejtat e tyre, ofroni edhe informacion lidhur me vendin dhe të drejtat e barabarta që duhet të gëzojnë këta persona, si dhe mbi rezultatet pozitive që ka arritur ky komunitet në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të tyre në Shqipëri dhe në botë.
- Nëse po intervistoni një person LGBTIQ apo një aktivist/aktiviste për të drejtat e personave LGBTIQ, e cila/i cili i përket këtij komuniteti, lejojeni atë vetë të marrë vendimin nëse do ta bëjë publik faktin që i përket komunitetit LGBTIQ apo jo. Mos i bëni presion dhe nuk është roli juaj që ta inkurajoni ta bëjë publik orjentimin e tij/saj seksual apo identitetin gjinor.
- Merrni informacion dhe mbani parasysh dallimet që egzistojnë mes të gjitha grupimeve të komunitetit LGBTIQ, si edhe faktin që organizata të ndryshme mund të kenë në fokus të tyre segmente të veçanta të këtij komuniteti.
- Megjithëse disa grupime dhe persona nga komuniteti LGBTIQ përdorin, në mënyrë taktike, fjalor apo terma poshtërues (si, p.sh., 'kuiër' ose 'lesbo'), për të nxjerrë në pah gjuhën e urrejtjes që përdoret ndaj tyre, ju si gazetar nuk duhet t'i përdorni këto terma. Ato mund të përdoren vetëm kur citohen si burim ose kur përzgjidhen nga personi

LGBTIQ, për të cilin po raportohet. Edhe kur përdoren në këtë kontekst, duhet të tregoni kujdes të shtuar për t'i ofruar audiencës suaj kontekstin e ngjarjes, në kuadër të së cilës përdoren këto terma nga personi LGBTIQ në fjalë.

- Përdorni terminologjinë e duhur dhe pasqyroni me respekt e dinjitet komunitetin LGBTIQ duke përcjellë historitë e tyre personale sa më mirë, në mënyrë të qartë dhe pa keqkuptime.
- Termat 'homoseksual' dhe 'transgjitor', nuk duhet të përdoren si emra. Një shembull tjetër: 'lezbike' përdoret në kontekst gjitor, ndërsa 'çift lezbikesh' është togfjalësh gramatikisht i saktë, termi 'grua lezbike' është përsëritje e panevojshme nga pikëpamja kuptimore.
- Kini kujdes në përdorimin e termit 'homoseksual'. Jashtë fushës shkencore dhe klinike, ky term është i vjetëruar. Kur raportoni mbi çështje të homoseksualitetit dhe transgjitore në kontekstin social, termat më të pranuar dhe më të përhapur janë 'LGBT', 'gej', 'lezbike', 'biseksual', 'transgjitor'.
- Shmangni përdorimin e termave si 'marrëdhënie homoseksuale', 'çift homoseksualësh'. Përdorni thjesht fjalën 'marrëdhënie' ose, nëse duhet dhe është e lidhur me ngjarjen, përdorni togfjalëshin 'lidhje seksuale'. Po njëjllon, duhet përdorur termi 'çift' dhe, vetëm nëse është e domosdoshme, duhet përdorur 'çift gej'.
- Mos e përdorni termin 'preferencë seksuale', por përdorni termin 'orientim seksual'. Termi 'preferencë seksuale' ushqen idenë se të qenit lezbike, gay, biseksual apo transgjitor është një zgjedhje e lirë. Kjo është e vërtetë vetëm në pak raste, Për më tepër, termi 'preferencë seksuale' është përdorur nga lëvizja kundër të drejtave të komunitetit LGBTIQ, e cila kërkon që personat LGBTIQ 'të kurohen' nga 'preferencat' e tyre seksuale. Kjo qasje ka shkaktuar trauma të rënda dhe tragjedi personale e familjare tek mjaft persona LGBTIQ.
- Mos përdorni shprehjen 'homoseksual i pranuar', por përdorni shprehjet 'lezbike që ka dalë hapur', 'gej që ka dalë hapur', 'biseksual që ka dalë hapur'.

- Mbani parasysh se shprehjet ‘stili i jetës së një personi gej’ dhe ‘stili i jetës së një homoseksuali’ përdoren më së shumti në një kuptim dashakeqës e fyes. Stili i jetës së personave nga komuniteti LGBTIQ është po aq i larmishëm sa edhe ai i të gjithë anëtarëve të tjerë në një shoqëri.
- Mos përdorni dhe mos përsërisni shprehje si ‘axhenda gej’, ‘axhenda e homoseksualëve’, ‘axhenda LGBT’, sepse këto shprehje ushqejnë frikërat homofobike dhe stereotipet lidhur me rolin e komunitetit LGBTIQ. Përdorni terma që promovojnë barazinë dhe synojnë në eliminimin e bulizmit dhe diskriminimit të komunitetit LGBTIQ.
- Kur raportoni për personat transgjnorë:
 - Mos e përmendi faktin që personi është transgjnor, nëse nuk është absolutisht e nevojshme.
 - Mos investigoni për jetën personale të personave transgjnorë vetëm duke u nisur nga shkakut se ajo/ai është vetëdeklaruar si i/e tillë.
 - Ashtu si edhe për të gjithë anëtarët e tjerë të shoqërisë, respektoni privatësinë e jetës personale dhe dinjitetin e personit, kur raportoni për ngjarje që kanë të bëjnë me persona transgjnorë.
 - Gjithmonë drejtojeni personit transgjnor në emrin e zgjedhur prej tij/saj. Duhet ta pyesni atë paraprakisht në lidhje me preferencat e tij për emrin apo mbiemrin, me të cilin ai/ajo identifikohet.
 - Shmangni vendosjen në thonjëza të emrit ose përemrit të një personi transgjnor.
 - Mos përdorni termin ‘ndryshim seksi’, por përdorni shprehjen ‘është në fazë tranzicioni’. Mos vini kurrë theksin tek ndërhyrja kirurgjikale, kur raportoni për personat transgjnorë.
 - Termin ‘transgjnor’ mos e përdorni si emër, por përdorni gjithnjë shprehjen ‘person transgjnor’.
 - Evitoni përdorimin e termit ‘transeksual’, sepse kohët e fundit përdorimi i këtij termi kufizohet kryesisht në shkencë dhe në mjekësi.
 - Kur i referoheni identitetit gjnor, mbani parasysh se një person, i cili ka lindur burrë dhe është në fazë tranzicioni për t’u bërë grua, është ‘grua transgjnore’. Po njëjloj, një person që ka lindur grua dhe është në periudhë tranzicioni për t’u bërë burrë, është një ‘burrë transgjnor’.

C. Burime të vlefshme

*Dokumente të rëndësishme*²¹

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI 2016 - 2020
<https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/Plani-LGBTI-2016-2020-KM.pdf>

Ligji nr.10221, datë 4.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
<https://www.shendetesia.gov.al/ligje-7/>

Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

Ligj Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”

Ligj Nr.10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”

²¹ Për dokumentat, për të cilat nuk është vendosur një adresë në internet, mund të kontaktoni Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mirëqenies Sociale.

Institucione publike dhe OSHC lokale

Avokati i Popullit

www.avokatipopullit.gov.al

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

www.kmd.al

Aleanca kundër diskriminimit të Personave LGBTI

Rr. "Mine Peza", nr. 75, Tiranë

+355 69 64 84 490; aleanca.al@gmail.com;

info@aleancalgbt.org; www.aleancalgbt.org

Streha për Personat LGBTI

+355 67 21 95 736; strehalgbt@gmail.com; www.strehalgbt.al

OMSA, Open Mind Spectrum Albania

Rr. "Mihal Grameno", pall. 10, shk. 1, apt. 6, Tiranë

+355 69 39 53 920; omsa.albania@gmail.com; www.omsalbania.org

Pink Embassy

Tiranë

+355 42 265 741; pinkembassy@crca.al info@pinkembassy.al;

www.pinkembassy.al

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti për Kontratën Shoqërore

Udhëzues për perspektivën gjinore dhe
përfshirjen sociale në media / SCI ;
përg. Blerta Çani, Delina Fico, Iris Luarasi.
– Tiranë : Publicita, 2019
60 f. ; 14.5 x 20.5cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-231-12-3

1.Përkatësia gjinore 2.Masmedia
3.Politika sociale 4.Shqipëri

659.3(496.5) :316.346.2

ISBN 978-9928-231-12-3



9 789928 231123